



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. 09/44 Prot.

Tiranë më, 16/02/2023

V E N D I M

Nr. 09 datë 02.02.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

| | |
|--------------------|-----------------|
| Denisa Sina | Kryesues |
| Suela Bulku | Relator |
| Arben Sefaj | Anëtar |

Asistuar nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Ersila Kalaja, më datë 15.01.2024, ora 09:00, në Tiranë, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Z. Zenel Tahir Hyka**, me funksion Drejtor i Departamentit për Shërbimet Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI: **Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të relatores së çështjes, Znj. Suela Bulku, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Z. Zenel Hyka, i cili në seancë dëgjimore kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, **Z. Zenel Hyka** është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023 si “Drejtor i Departamentit për Shërbimet Mbështetëse”.
3. Subjekti i vlerësimit, **Z. Zenel Hyka**, i’u nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë të Brendshme nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislationit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. ** datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit, e përbërë nga: Znj. Suela Bulku (Relatore), Znj. Denisa Sina (Kryesuese) dhe Z. Arben Sefaj (Anëtar).
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin 09/2 datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit **Z. Zenel Hyka**.
6. Relatori i çështjes, Znj. Suela Bulku, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar, datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të

vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Më datë 19.04.2023, në zbatim të nenit 33/1, nenit 42 dhe nenit 46, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, janë dërguar formularët e administruar nga ana e relatorit, pranë institucioneve ndihmëse, e konkretisht:

- ✓ Me shkresën nr. *** prot. datë 19.04.2023, është dërguar formulari i deklaramit të pasurisë, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit.
- ✓ Me shkresën nr. *** prot. datë 19.04.2023, është dërguar formulari i deklaramit të aftësive profesionale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- ✓ Me shkresën nr. *** prot. datë 19.04.2023, është dërguar formulari i deklaramit të kontrollit të figures, pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.

8. Subjekti i vlerësimit, ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, në datën 19.04.2023, duke shprehur se **nuk është** në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

9. Relatori i çështjes, në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:

- ✚ Vlerësimin e pasurisë;
- ✚ Kontrollin e figurës;
- ✚ Vlerësimin e aftësive profesionale.

12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
- c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
- d. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
- e. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit

12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.

- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI nr. 15 datë 27.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme’ i ndryshuar
- g. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”

Gjithashtu trupa e vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- + Deklarata e Pasurisë,
- + Deklarata për Kontrollin e Figurës,
- + Formulari i Vlerësimit Profesional
- + Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,
- + Raportin e Vlerësimit të Pasurisë nga ILDKPKI
- + Raportin e Vlerësimit të Figurës nga AMP
- + Raportin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale nga DPPSH
- + Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- + provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- + ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

13. Trupa e vlerësimit, më datë 06.12.2023, pasi dëgjoi relatorin dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Zenel Hyka, me Vendimin nr. 3 datë 06.12.2023, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit **Z. Zenel Tahir Hyka;**
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - + Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;
 - + Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;
- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12 dhe 14, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
15. Në datën 12.01.2024, trupa e vlerësimit njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 15.01.2024, në orën 09:00, Salla e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE.

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Zenel Hyka, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 15.01.2023, subjekti i vlerësimi z. Zenel Hyka, kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 02.02.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Subjekti i vlerësimit z. Zenel Hyka, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

- ✚ Prosesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit, deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
- ✚ Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **Z. Zenel Hyka** ka dorëzuar deklaratën e pasurisë, brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. 22 indexi, viti 2023.
- ✚ Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

- ✚ Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
- ✚ Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- ✚ deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- ✚ provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI:

ILDKPKI, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar raportin nr. ***, datë 31.07.2023, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Zenel Hyka, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, është konstatuar se:

- a) **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- b) **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**

- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

Zenel Hyka, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI, në vitin 2018, me numër indeksi 14862 dhe sipas deklarimit online me numër indeksi 2725. Në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë, si më poshtë:

- Para fillimit të detyrës 2018
- Pas largimit nga Funkzioni 2018
- Para fillimit të detyrës 2021
- Periodike/Vjetore 2021
- Periodike/Vjetore 2021

DEKLARIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT- ZENEL HYKA

DEKLARIMI I PASURIVE

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

1. **Truall + Ndërtesë me sip. totale 479.3 m2**, sip. takuese 239.65 m2, nr. pasurie ***, ZK ***, Vol. ***, Fq ***, Tiranë. Data e regjistrimit 21.11.2018. Shtëpi banimi me sip. 600 m2 (2 kate dhe bodrum) e ndërtuar vetë, Rr. “Sadik Petrela”, Nr. **, Tiranë, në bashkëpronësi me vëllain tim, Xh.H. Vlera 0 lekë. Pjesa takuese 50%. Shtëpi e pavlerësuar në vlerë leku. Ka filluar të ndërtohet në vitin 1993 dhe ka përfunduar në vitin 2006, me kursimet familjare ndër vite të miat dhe vëllait tim, si dhe aktiviteti i tokës në fshat.

Bashkëlidhur deklaratës:

- *Certifikatë për vërtetim pronësie ****, datë 21.11.2018, për pasurinë nr. ***, ZK ***, Vol. ***, Fq ***, truall e sip. 479.3 m2, nga i cili ndërtesë me sip. 160.5 m2, Tiranë, në emër të Xh.H dhe Zenel Tahir Hyka me 1/2 pjesë takuese.*

Hetimi Administrativ

- 🚩 **ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Jug**, me shkresën nr. *** prot, datë 26.06.2023, konfirmon në emër të Zenel Hyka, pasurinë nr ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, regjistrim me Leje Legazimi. Bashkëlidhur:

- Kartela e pasurisë se palujtshme nr ***, ZK ***, me sip. totale 479.3 m2, nga e cila ndërtesë me sip. 160.5 m2, në emër të Zenel dhe Xh. Hyka, me shënimin "leje legalizimi nr. ***, datë 27.04.2018; godinë banimi 3 kt; sip. kt. përdhe, 160.5 m2; sip. verande, 17.6 m2; sip. kt. parë, 191.5m2; sip. kt. dytë, 189.8 m2". Datë regjistrimi 21.11.2018. Harta treguese e regjistrimit.
- Fatura për arkëtim nr. ***, datë 02.10.2017; formulari i pagesës së parcelës ndërtimore nr. ***, datë 02.10.2017, në emër të Zenel dhe Xh. Hyka; shuma e paguar në lekë është 345.096 lekë, shuma e paguar në bono është 480.000 lekë. Pjesa takuese e subjektit llogaritet rreth 173.000 lekë.
- Leje Legalizimi nr. ***, datë 27.04.2018, i jepet Zenel dhe Xh. Hyka, për objektin Godinë banimi tre kate, sip. parcelës ndërtimore 479.3 m2, sip. totale e ndërtimit 559.4 m2, nr. kateve tre.
- Genplan i zonës. Planimetritë e kateve përdhe, kati parë dhe kati dytë.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD, ku evidentohet në emër të Zenel Hyka, Kredi në shumën 103.000 lekë, datë 29.10.2007; 129.600 lekë, datë 27.04.2012 dhe Lindita Hyka, kredi në shumën 135.540 lekë. Datë 27.04.2012.

- **Me inventarin datë 26.06.2023**, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave:
 - Shprehja “shtëpi e pa vlerësuar në vlerë leku” është thënë pasi shtëpia është ndërtuar për një periudhë kohe të gjatë, kjo për shkak të mundësive ekonomike.
 - Lidhur me vlerën e investuar në shtëpinë e banimit, sqaron se ndërtimi ka filluar në vitin 1993 dhe ka vazhduar me periudha, deri në vitin 2006. Thekson se shtëpia është ndërtuar me shumë solidaritet. Në ndërtimin e saj janë angazhuar të gjithë si fuqi punëtore, përfshirë këtu edhe miqtë dhe nipat, që kanë ndihmuar kohë pas kohe. Të gjitha materialet drusore dhe inerte (gurë, rërë, zhavorr), i kanë patur gjëndje në fshat. Pra, nuk është mbajtur një evidencë e shpenzimeve, për të bërë një vlerësim të saj se sa ka qenë kostoja e ndërtimit. Por për nevoja të këtij deklarami, është përgatitur një raport vlerësimi. Ndërtimi është financuar me të ardhurat nga puna e subjektit, bashkëshortes si punonjëse në Ministrinë e Financave që nga viti 1994, nga aktiviteti bujqësor në fshat që para vitit 1990 dhe që është shtuar pas këtij viti.
 - Lidhur me periudhën kur kanë filluar të jetojnë në shtëpinë e banimit të deklaruar më sipër, si dhe cili ka qenë vendbanimi para kësaj periudhe dhe shpenzimet e kryera, sqaron se deri në vitin 1998 kanë jetuar në fshatin Barbas, Petrelë, Tiranë, në shtëpinë e përbashkët të prindërve. Nga viti 1991 e në vazhdim, familja e përbërë nga nëna, subjekti, vëllai dhe motra, kanë administruar një ekonomi të kënaqshme bujqësore dhe blegtorale, nga e cila përfitonin të ardhura. Nuk u investua për të rindërtuar shtëpinë në fshat, por në vitin 1993, vëllai investoi për të ndërtuar shtëpinë në qytet. Në fund të vitit 1997 dhe në fillim të vitit 1998, u dakortësua që shtëpinë që po ndërtohej, ta kishim të përbashkët, duke e ndarë sipërfaqen përgjysëm. Deri në vitin 1995 subjekti ka qenë beqar, ku në vitin 1995 është martuar dhe deri në vitin 1998 kanë jetuar në fshat, në shtëpinë e prindërve të subjektit. Deri në vitin 1998 shpenzimet kanë qenë minimale, pasi në fshat kanë pasur prodhime bujqësore dhe blegtorale, që i kanë shoqëruar edhe kur kanë ardhur në qytet jo vetëm për plotësimin e nevojave, por edhe për ti shitur.

- Lidhur me periudhën e ndërtimit të shtëpisë së banimit në vitin 1995, deklaruar në deklaratën e interesave private “Para Fillimit të Detyrës 2018”, subjekti sqaron se shtëpinë në fillim e ka nisur për ndërtim vëllai. Sqaron se shtëpia është me themele, oborr dhe kulm të përbashkët. Kuptimi i shprehjes “akoma po e mbarojmë”, ka të bëjë me nevojën që ka shtëpia private për punime të brendshme, suva të jashtme, rrethime dhe drenazhime.
- Lidhur me shpenzimet për mobilim, por edhe konfigurimet nga Raiffaisen Bank, sqaron se:
 - o Në vitin 2007, subjekti ka përdorur overdraftin në shumën 103.000 lekë në Raiffaisen Bank, për mobilimin e dhomës së vajzave, rreth 90.000 lekë.
 - o Në vitin 2012, kanë blerë pajisje elektroshtëpiake me vlerë 133.540 lekë, me kredi, në Raiffaisen Bank, marrë nga bashkëshortja dhe 126.000 lekë, me kredi, po në Raiffaisen Bank, marrë nga subjekti.
 - o Në vitin 2014, kanë bërë kuzhinën me vlerë 120.000 lekë, dhomë gjumi me vlerë 90.000 lekë dhe kënd me vlerë 70.000 lekë.
Shuma totale e pajisjeve shtëpiake dhe mobilimit, është rreth 643.000 lekë.

Subjekti paraqiti:

- Raport Vlerësimi datë 21.06.2023, me objekt: Truall + Ndërtesë (objekti tre kate mbi tokë) pasuria nr. ***, Rr. “Sadik Petrela” aktualisht “Arian Xhumari”, Njësia Bashkiake nr. 3, Bashkia Tiranë, sipas së cilit, ndër të tjera, vlerësimi i punimeve është bërë nga verifikimet në terren për punimet e matshme, informacionin e marrë nga analiza e çmimeve sipas manualit të çmimeve të për vitet 1993 – 1998 dhe 2005; për vitin 1997 – 1998, referuar vendimit nr. 13, datë 05.01.1998 dhe për vitin 2005, referuar vendimit nr. 5, datë 23.11.2005.

Duke qënë se prona zotërohet dhe banohet aktualisht nga dy vëllezërit, Zenel dhe Xh. Hyka, ku secili prej tyre ka nga ½ pjesë të kësaj pasurie, objekt vlerësimi është vetëm pjesa takuese e Zenel Hykës dhe konkretisht sip. totale prej 270.9 m² + verandë 8.8 m², nga të cilat kati përdhe me sip. 80.25 m² + verandë 8.8 m²; kati i parë me sip. 95.75 m² dhe kati i dytë me sip. 94.9 m². Bashkëlidhur pamje fotografike të objektit nga jashtë dhe brenda.

Në konkluzion të analizës, vlera e investimit në total, përgjatë periudhës 1994-2005, përlllogaritet në shumën 4.265.404 lekë dhe konkretisht:

- Vlera e punimeve të realizuara për ndërtimin e kt. përdhe, faza e karabinasë, viti 1994, shuma 248.126 lekë.
- Vlera e punimeve të realizuara për ndërtimin e kt. 1, fundviti 1997 - viti 1998, shuma 1.269.032 lekë.
- Vlera e punimeve të realizuara për ndërtimin e kt. përdhe, sip. verandes, viti 2005, shuma 88.591 lekë.
- Vlera e punimeve të realizuara për përfundimin e rafiniturave të brendshme, kt. përdhe, viti 2005, shuma 1.131.050 lekë.
- Vlera e punimeve të realizuara për rafiniturat e kt. 2, viti 2005, shuma 1.528.604 lekë.

- Formulari i Vetëdeklarimit për Legalizim nr. ***, me prot. nr. ***, datë 23.05.2005, në emër të Zenel dhe Xh. Hyka, për shtëpi banimi, Kodra e Priftit, viti i ndërtimit 1993 e në vazhdim. Sip. ndërtimit rreth 200 m², numri i kateve mbi tokë, 2.
 - Foto të shtëpisë.
 - Leje Legalizimi nr. ***, datë 27.04.2018, i jepet Zenel dhe Xh. Hyka, për objektin Godinë banimi 3 kate, sip. parcelës ndërtimore 479.3 m², sip. totale e ndërtimit 559.4 m², nr. kateve tre. Genplan i zonës.
 - Kërkesë nr. ***, datë 19.05.2018, drejtuar ZVRPP Tiranë, për regjistrimin e lejes së legalizimit.
 - Fatura për arkëtim nr. ***, datë 02.10.2017 dhe formulari i pagesës së parcelës ndërtimore nr. ***, datë 02.10.2017. Mandat pagesa në Credins Bank, datë 15.11.2017, shuma 480.000 lekë, paguar me Bono Privatizimi dhe 345.000 lekë. Pjesa takuese e subjektit llogaritet rreth 173.000 lekë.
 - Certifikatë e Pronësisë nr. ***, nga ZRPP Tiranë, për truall me sip. 479.3 m², nga i cili 160.5 m² ndërtesë, në emër të Zenel dhe Xh. Hyka. Harta treguese e regjistrimit.
 - Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, ZK ***, në emër të Zenel dhe Xhevdet Hyka me shënimin "leje legalizimi nr. ***, datë 27.04.2018; godinë banimi 3 kt; sip. kt. përdhe 160.5 m²; sip. verandë 17.6 m²; sip. kt. parë, 191.5 m²; sip. kt. dytë, 189.8 m²".
 - Planimetri e kateve.
 - Konfirmim për miratim kredie datë 26.04.2012, ku Lindita Hyka ka marrë shumën 133.540 lekë, për blerje frigoriferi dhe furrë. Fatura e blerjes datë 26.04.2012.
 - Konfirmim për miratim kredie, datë 26.04.2012, ku Zenel Hyka ka marrë shumën 126.600 lekë, për blerje lavatriçe dhe lavastovilje. Fatura e blerjes datë 26.04.2012.
 - Kontratë kredi me kufi, datë 25.04.2012, ku Lindita Hyka merr nga Raifeisen Bank, shumën deri në 200.000 lekë.
- **Në proces verbalin e datës 18.7.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, lidhur me vlerat e investuara ndër vite dhe burimet e financimit, subjekti sqaron se shtëpia ka filluar të ndërtohet nga vëllai në vitin 1993. Faza e karabinas për ndërtimin e katit përdhe në pjesën e tij, është bërë në vitin 1994, po nga ana e vëllait, por duke u kompensuar shpenzimet, lidhur edhe me marrëdhëniet e posaçme të vëllazërisë. Burimet e financimit ndër vite kanë qënë të ardhurat nga paga dhe shpërblime familjare. Gjithashtu, një lehtësi shumë e madhe ka qënë shfrytëzimi i ekonomisë bujqësore dhe blegtorale të familjes, falë tokave bujqësore që trashëguan dhe disponojnë, gjë që ka bërë uljen/reduktimin pothuaj totalisht të përdorimit të të ardhurave për shpenzime konsumi. Thekson se deri në vitin 1998, jetonin në shtëpinë e prindërve në Barbas, vit në të cilin edhe u dakortësuan me vëllain që shtëpinë ta ndanin së bashku dhe secili të investonte pjesën e vet.

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

Shtëpia e banimit me sip. totale takuese prej 270.9 m² + verandë 8.8 m², është përfituar me Leje Legalizimi në vitin 2018. Formulari i vetëdeklarimit për legalizim datë 23.05.2005, për shtëpi banimi, adresa Kodra e Priftit, viti i ndërtimit 1993 e në vazhdim, është bërë nga Zenel dhe Xh. Hyka.

Ndërtimi ka filluar në vitin 1993 nga vëllai i subjektit, ndërsa faza e karabinasë për ndërtimin e katit përdhe në pjesën e tij, është bërë në vitin 1994. Vlera totale e investimit sipas raportit të vlerësimit të paraqitur, llogaritet rreth 4.265.000 lekë, nga të cilat rreth 248.000 lekë janë investuar në vitin 1994; rreth 1.269.000 lekë janë investuar në fund të vitit 1997 e gjatë vitit 1998 dhe rreth 2.748.000 lekë janë investuar në vitin 2005. Burim financimi janë deklaruar të ardhurat familjare ndër vite, por edhe shfrytëzimi i ekonomisë bujqësore dhe blegtorale të familjes, me anë të të cilave është mundësuar jetesa (subjekti zotëron tokë bujqësore arë dhe ullishte).

Gjithashtu, subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka dokumentuar, lidhur me shpenzimet e mobilimit të kryera ndër vite, të cilat janë rreth 643.000 lekë, me burim kryesisht financime nga Raiffeisen Bank, e cila konfirmon kreditimet përkatëse.

- ✓ **Konfirmohet trualli i deklaruar me sip. 479.3 m² + ndërtesë 3 kate, me sip. totale 559.4 m², në emër të Zenel dhe Xhevdet Hyka me përgjigjen e ASHK. Aset i krijuar para vitit 2008.**
 - ✓ **Vlera totale e investimit gjatë viteve 1994 - 2005, për ndërtimin e pjesës takuese të subjektit (sip. tot. ndërtimi 270.9 m² + 8.8 m² verandë), bazuar në dokumentacionin e dorëzuar është 4.265.404 lekë, me burim të ardhurat nga punësimi, krijuar gjatë periudhës 1990 - 2005. Shpenzimet për pagesën e parcelës ndërtimore në vitin 2017, janë rreth 173.000 lekë (pjesa takuese).**
 - ✓ **Konfirmohen shpjegimet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank, lidhur me shpenzimet e kryera për blerjen e pajisjeve shtëpiake, të cilat sëbashku me mobilimin ndër vite, janë në shumën rreth 643.000 lekë.**
 - ✓ **Dokumentacioni i të ardhurave të subjektit dhe bashkëshortes, për perindhën 1990 - 2005, trajtohet në vijim në rubrikat përkatëse të të ardhurave.**
2. **Tokë arë dhe kullota me sip. totale 48.078 m²**, për të cilën kemi aplikuar në ASHK, me shkresën nr. ***, datë 29.03.2021, të Njesisë Administrative Petrelë, Tiranë, në zbatim të Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtarë të pronësisë". Vlera 0 lekë. Pjesa takuese 14.3%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Shkresë nr. ***, datë. 06.04.2021 "Dërgim dokumentacioni", të Njesisë Administrative Petrelë, drejtuar ASHK, Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 1, në përmbushje të Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë".

Hetimi Administrativ

- 🇹🇷 **ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1**, me shkresën nr. *** prot, datë 26.06.2023, nuk e konfirmon pasurinë.

- **Me inventarin datë 26.06.2023**, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave, kjo është pronë e trashëguar e familjes prej vitesh dhe nuk është përfituar me ligjin 7501. Aktualisht nuk e disponojnë, por në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2020, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore" me ndryshimet përkatëse, është aplikuar për rifitim të pronës, nëpërmjet Njesisë Administrative Petrelë, në Agjencinë Shetërore të Kadastrës. Pjesa takuese është 14.5%, sepse janë 7 fëmijë dhe kanë pjesë të barabarta. Këtë pronë e kanë shfrytëzuar gjatë gjithë kohës, pas viteve 1990, për prodhime bujqësore dhe mbarështimin e blegtorisë.

Renditja e pasurisë sipas Procesverbalit nr. ***, datë 29.03.2021, të Njesisë Administrative Petrelë, është si vijon:

| Nr. | Nr. Pasurie sipas Plan - Rilevimit | Zona Kadastrale | Sip/m² |
|------------|---|------------------------|--------------------------|
| 1 | Plan Rilevimi për pasurinë nr. 170/3 | 1433 | 5600 |
| 2 | Plan Rilevimi për pasurinë nr. 642 | 1433 | 15000 |
| 3 | Plan Rilevimi për pasurinë nr. 708 | 1433 | 19400 |
| 4 | Plan Rilevimi për pasurinë nr. 169 | 1433 | 7418 |
| 5 | Plan Rilevimi për pasurinë nr. 714/2 | 1433 | 600 |
| 6 | Plan Rilevimi për pasurinë nr. 169/1 | 1433 | 670 |
| 7 | Plan Rilevimi për pasurinë nr. 465/1 | 1433 | 3600 |
| 8 | Plan Rilevimi për pasurinë nr. 176/2/1 | 1433 | 290 |
| 9 | Plan Rilevimi për pasurinë nr. 176/1 | 1433 | 540 |
| | Totali | | 48078 |

Subjekti paraqiti:

- Shkresë nr. ***, datë 06.04.2021 "Dërgim dokumentacioni", të Njesisë Administrative Petrelë, drejtuar ASHK, Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 1, në përmbushje të Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë".
- Procesverbal nr. ***, datë 29.03.2021, i Njesisë Administrative Petrelë, mbi dokumentat e dorëzuara me kërkesën nr. *** prot. datë 30.10.2020, të z. Zenel Hyka, në zbatim të Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë". Sip. e tokës sipas plan rievimeve, në total 48.078 m2.
- Certifikata e përbërjes familjare, datë 01.08.1991, lëshuar nga Njësia Administrative Petrelë, me pjestarë: I.H, Zenel Hyka, N.H dhe Xh.H.
- ✚ **Konstatohet se**, pasuria tokë arë dhe kullota me sip. totale 48.078 m2, ku subjekti deklaron pjesë takuese 14.3%, do të përfitohet në zbatim të Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtarë të pronësisë". Prona është shfrytëzuar gjatë gjithë kohës, pas viteve 1990, për prodhime bujqësore dhe mbarështimin e blegtorisë.
- ✓ **Deklarimi bazohet në dokumentacionin e dorëzuar. ASHK nuk e konfirmon pasurinë e deklaruar.**

3. **Tokë arë me sip. totale 6000 m2**, nr. pasurie ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, Tiranë. Data e regjistrimit 10.10.2012. Vlera 0 lekë. Pjesa takuese 25%. Lënë si kolateral për Procredit Bank. Burimi i krijimit: Përfituar me Ligjin 7501, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, datë 03.07.1992.
4. **Tokë arë me sip. totale 3687 m2**, nr. pasurie ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, Tiranë. Data e regjistrimit 10.10.2012. Vlera 0 lekë. Pjesa takuese 25%. Burimi i krijimit: Përfituar me Ligjin 7501, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, datë 03.07.1992.
5. **Tokë arë me sip. totale 8125 m2**, nr. pasurie ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, Tiranë. Data e regjistrimit 31.03.1997. Vlera 0 lekë. Pjesa takuese 25%. Lënë si kolateral për Procredit Bank. Burimi i krijimit: Përfituar me Ligjin 7501, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, datë 03.07.1992.
6. **Tokë arë me sip. totale 1200 m2**, nr. pasurie ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, Tiranë. Data e regjistrimit 10.10.2012. Vlera 0 lekë. Pjesa takuese 25%. Lënë si kolateral për Procredit Bank. Burimi i krijimit: Përfituar me Ligjin 7501, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, datë 03.07.1992.
7. **Tokë arë me sip. totale 2000 m2**, nr. pasurie ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, Tiranë. Data e regjistrimit 31.03.1997. Vlera 0 lekë. Pjesa takuese 25%. Lënë si kolateral për Procredit Bank. Burimi i krijimit: Përfituar me Ligjin 7501, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, datë 03.07.1992.
8. **Tokë arë me sip. totale 812 m2**, nr. pasurie ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, Tiranë. Data e regjistrimit 10.10.2012. Vlera 0 lekë. Pjesa takuese 25%. Burimi i krijimit: Përfituar me Ligjin 7501, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, datë 03.07.1992.
9. **Tokë arë me sip. totale 1200 m2**, nr. pasurie ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, Tiranë. Data e regjistrimit 10.10.2012. Vlera 0 lekë. Pjesa takuese 25%. Burimi i krijimit: Përfituar me Ligjin 7501, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, datë 03.07.1992.
10. **Ullishte me sip. totale 1000 m2**, nr. pasurie ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, Tiranë. Data e regjistrimit 10.10.2012. Vlera 0 lekë. Pjesa takuese 25%. Lënë si kolateral për Procredit Bank. Burimi i krijimit: Përfituar me Ligjin 7501, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, datë 03.07.1992.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Akti i marrjes së tokës në pronësi në emër të Xh.H, fshati Barbas, të cilit i jepet në pronësi 23.600 m2 tokë gjithsej, ullishte 45 rrënje dhe truall 300 m2.
- Certifikatë për vërtetim pronësie ***, datë 10.10.2012, për pasurinë nr. ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, arë me sip. 6000 m2, Gurrë, Tiranë, në emër të Xh.H.
- Certifikatë për vërtetim pronësie ***, datë 10.10.2012, për pasurinë nr. ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, arë me sip. 3687 m2, Barbas, Tiranë, në emër të Xh.H.

- Certifikatë për vërtetim pronësie ***, datë 10.10.2012, për pasurinë nr. ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, arë me sip. 8125 m2, Barbas, Tiranë, në emër të Xh.H.
- Certifikatë për vërtetim pronësie ***, datë 10.10.2012, për pasurinë nr. ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, arë me sip. 1200 m2, Barbas, Tiranë, në emër të Xh.H.
- Certifikatë për vërtetim pronësie ***, datë 10.10.2012, për pasurinë nr. ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, arë me sip. 2000 m2, Barbas, Tiranë, në emër të Xh.H.
- Certifikatë për vërtetim pronësie ***, datë 10.10.2012 për pasurinë nr. ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, arë me sip. 812 m2, Barbas, Tiranë, në emër të Xh.H.
- Certifikatë për vërtetim pronësie ***, datë 10.10.2012 për pasurinë nr. ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, arë me sip. 1200 m2, Barbas, Tiranë, në emër të Xh.H.
- Certifikatë për vërtetim pronësie ***, datë 10.10.2012 për pasurinë nr. ***, ZK ***, Vol. **, Fq. ***, ullishte me sip. 1000 m2, Barbas, Tiranë, në emër të Xh.H
- Marrëveshje për ndryshimin e kontratës së kredisë (ristrukturim kredie), datë 31.08.2021, kredi dhënës Procredit Bank. Pasuritë e hipotekuara: arë me sip. 1200 m2, 2000 m2, 6000 m2, 8125 m2, 1000 m2 dhe ullishte me sip. 750 m2, në emër të Xh.H, me adresë në fshatin Barbas, Tiranë.

Hetimi Administrativ

🚩 **ASHK, Drejtoritë Vendore Tiranë**, me shkresat nr. *** prot, nuk i konfirmojnë pasuritë.

- **Me inventarin datë 26.06.2023**, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave në lidhje me tokën e përfutur me ligjin 7501, renditja e pasurisë sipas AMTP-së, datë 03.07.1992, Barbas, Njësia Administrative Petrelë, depozituar në ASHK dhe shkresën e datës 16.09.2012, të këtij institucioni, është si vijon:

| Nr. | Nr. Pasurie | Zona Kadastrale | Sip/m ² |
|-----|---------------------------|-----------------|--------------------|
| 1 | Për pasurinë nr. 155/2 | 1906 | 6000 |
| 2 | Për pasurinë nr. 80/1 | 1433 | 3687 |
| 3 | Për pasurinë nr. 176/1/26 | 1433 | 8125 |
| 4 | Për pasurinë nr. 176/1/28 | 1433 | 1200 |
| 5 | Për pasurinë nr. 169/11 | 1433 | 2000 |
| 6 | Për pasurinë nr. 585/4 | 1433 | 812 |
| 7 | Për pasurinë nr. 176/1/30 | 1433 | 1200 |
| 8 | Për pasurinë nr. 169/4 | 1433 | 1000 |
| | Totali | | 24024 |

Të gjitha këto pasuri, janë me certifikata pronësie, të regjistruara në vitin 2012. Diferenca prej 424 m2, midis sipërfaqeve të regjistruara dhe asaj me AMTP, mund të jetë kompensimi i sipërfaqes së ullishtes. Tokat janë në emër të vëllait, Xh.H, sepse sipas certifikatës familjare të vitit 1991, familja ka qënë prej 4 anëtarësh, nëna, vëllai, subjekti dhe motra.

Subjekti paraqiti:

- Shkresë kthim përgjigje datë 16.09.2012, nga ZVRPP Tiranë, sipas së cilës, nga verifikimi në arshivë, rezultoi se ndodhet e depozituar AMTP në pronësi të Xh.H. Bashkëlidhur si më poshtë:
 - AMTP datë 03.07.1992, sipas të cilës, familjes së Xh.H, nga fshati Barbas, i jepet tokë gjithsej 23.600 m², ullishte 45 rrënje dhe truall 300m².
 - Certifikata e përbërjes familjare datë 01.08.1991, lëshuar nga Njësia Administrative Petrelë, me pjestarë: I.H, Zenel Hyka, N.H dhe Xh.H.
- ✚ **Konstatohet se**, pasuritë janë përfituar nga Ligji 7501, sipas AMTP, në emër të familjes së Xh.H (vëllai), sipas certifikatës së gjendjes familjare datë 01.08.1991, ku pjesë përbërëse është edhe subjekti, Zenel Hyka.
- ✓ **Deklarimi bazohet në dokumentacionin e dorëzuar. ASHK nuk i konfirmon pasuritë e deklaruara.**

11. Llogari bankare për paga në Raiffesisen Bank me nr. *****. Vlera 451.600 lekë, datë 08.03.2023. Pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: Kursime nga pagat.

Hetimi Administrativ

- ✚ **Raiffesisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se Zenel Hyka, në datën 08.03.2023, ka llogari page me gjëndje 451.650 lekë.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e ardhur nga Raiffesisen Bank.**

12. Apartament me adresë Rr. Irfan Tomini, marrë nga Ministria e Brendshme në vitin 1997, si punonjës i këtij institucioni. Ky apartament është shitur në vitin 2014, në vlerën 2.968.700 lekë. Pjesa takuese 100%.

Hetimi Administrativ

- ✚ **ASHK, Drejtoritë Vendore Tiranë**, me shkresat nr. *** prot, nuk e konfirmojnë pasurinë.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 8.5.2023, ka përcjellë CD me nxjerrje llogarie, në emër të Zenel Hyka, ku figuron:
 - Kreditimi i pagave për periudhën janar - shtator 2006, në shumën rreth 512.000 lekë.
 - Kreditim i shumës 2.968.700 lekë, datës 05.08.2014, me përshkrimin “pagesë në bazë të kontratës së shitblerjes, pronë nr. rep. ***, nr. kol. ***, datë 14.07.2014”.
 - Shlyerje detyrimi në shumën 300.000 lekë, datë 24.12.2014, nga E.G.

Gjithashtu, ka përcjellë CD me nxjerrje llogarie, në emër të Lindita Hyka, ku figuron:

- Kreditimi i pagave për periudhën janar - shtator 2006, në shumën rreth 499.000 lekë.
- Kredi e disbursuar më datën 14.09.2006, në shumën 500.000 lekë, tërhequr më datë 15.09.2006.
- **Me inventarin datë 26.06.2023**, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave, apartamentin në Rr. "Irfan Tomini" pallati nr. **, shk. **, ap. **, me sip. 58.3 m2, e ka përfituar nga EKB në vitin 1997. Apartamenti është shitur në vitin 2014, me kontratën nr. ***, datë 14.07.2014, në shumën 3.000.000 lekë. Shuma është përdorur pjesërisht për nevoja familjare dhe rreth 1.500.000 lekë janë përdorur për shlyerjen e kredisë.

Lindita Hyka ka marrë kredi në Raiffeisen Bank, më datën 14.09.2006, në shumën 500.000 lekë, për të shlyer detyrimin ndaj EKB për apartamentin.

Subjekti paraqiti:

- Autorizim nr. ***, datë 07.07.1997, i Ministrisë së Brendshme, drejtuar Entit Kombëtar të Banesave, Dega Tiranë, sipas së cilit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 2,3,4, datë 09.01.1995, Komisioni i Strehimit të Ministrisë së Brendshme, ka vendosur të strehojë qytetarin Zenel Hyka, në qytetin e Tiranës, me banesë me strukturë 1+1, me adresë banesën e H.J. Autorizimi është i vlefshëm për lidhje kontrate dhe privatizim banese.
- Kontratë e përkohshme, për shitje apartament banimi datë 16.09.1997, e lidhur midis Entit Kombëtar të Banesave dhe Zenel Hyka. Blerësi detyrohet të paguajë shumën 30.000 lekë, si paradhënie për banesën.
- Vërtetim nr. ***, datë 20.12.1995, nga Bashkia Tiranë.
- Kontratë shitblerje nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 08.03.2007, midis EKB dhe Zenel Hyka, për apartament në Rr. "Irfan Tomini" pallati nr. **, shk. **, ap. **, me sip. 58.3 m2. Vlera reale e apartamentit është 1.163.975 lekë, nga e cila është parapaguar shuma 30.000 lekë dhe pas zbritjeve në bazë të ligjit, shuma e mbetur prej 830.486 lekë, u pagua cash në datën 15.09.2006.
- Aplikim për regjistrim në ZVRPP, viti 2007. Harta treguese e regjistrimit.
- Vërtetim nga dokumentet hipotekor, datë 19.02.2007, për pasurinë nr. ***, apartament me sip. 58.3 m2, Rr. "Irfan Tomini", në emër të EKB.
- Certifikata e përbërjes familjare Zenel, Lindita dhe Elda Hyka, datë 09.07.1997.
- Certifikata e përbërjes familjare Zenel, Lindita, Elda dhe Erisa Hyka, datë 26.06.2006.
- Vërtetim nxjerrje nga arkiva noteriale, nr. rep. ***, datë 12.06.2023, i kontratës së shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.07.2014.
- Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.07.2014, ku Zenel dhe Lindita Hyka, i shesin L.S, apartamentin me sip. 58.3 m2, në Rr. "Irfan Tomini", Tiranë, në vlerën 3.000.000 lekë. Shuma do të likuidohet brenda 10 ditëve, nga nënshkrimi i kontratës dhe do të transferohet me autorizim të noteres në llogarinë e shitësit, pasi blerësi të jetë pajisur me certifikatën e pronësisë nga ZVRPP.
- Certifikatë për vërtetim pronësie ***, datë 20.06.2014, për apartament me sip. 58.3 m2, në Rr. "Irfan Tomini", në emër të Zenel dhe Lindita Hyka. Kartela e Pasurisë, datë regjistrimi 22.04.2013.

- Kontratë kredie bankare datë 14.09.2006, ku Lindita Hyka ka marrë nga Raiffeisen Bank, shumën 500.000 lekë.
- **Në proces verbalin e datës 18.7.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaron:
 - Lidhur me destinacionin e përdorimit të këtij apartamenti deri në vitin 2014, si dhe shpenzimet e mobilimit të kryera për të, se apartamenti është liruar nga poseduesi i mëparshëm rreth vitit 1999 - 2000. Nuk kanë kryer shpenzime mobilimi, pasi që prej vitit 1998 banonin në shtëpinë e ndërtuar fillimisht nga vëllai. Më pas, vendosën ta shisnin dhe në vitin 2014, shpenzuan rreth 300.000 lekë për ta mobiluar, me qëllim që shitja të ishte më e sigurt dhe e plotë.
 - Lidhur me konfirmimin nga Raiffeisen Bank, për shlyerjen e detyrimit në shumën 300.000 lekë nga E.G, sqaron se ky i fundit është bashkëshorti i L.S (pala blerëse e apartamentit në Rr. "Irfan Tomini") dhe shuma e dhënë është shuma e investuar në mobilimin e apartamentit para se ta shisnin.

Përsa më sipër, është konstatuar se ka një diferencë në vlerën e blerjes dhe shitjes së apartamentit, nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, diferencë për të cilën lind detyrimi ligjor për pagesën e tatimit në burim. **Subjekti sqaron:**

- Pasuria është e rivlerësuar në shumën 553.385 lekë, për të cilën ka mandat pagese të datës 24.03.2012. Në këto kushte nuk ka asnjë detyrim për tatimin në burim.

Nga verifikimet e kryera nga Trupa e Vlerësimit, në Regjistrin Noterial, rezultoi se në datën 08.07.2014, subjekti i vlerësimit dhe bashkëshortja e tij znj. Lindita Hyka, kanë nënshkruar një deklaratë noteriale, sipas së cilës deklarojnë se i kanë dhënë hua (borxh), shtetasit E.G, shumën prej 850.000 lekës. **Subjekti sqaron:**

- ...në fillim blerësi nuk kishte pranuar të blinte mobilimin e shtëpisë, vlera e të cilit ishte caktuar nga ana e subjektit 850 000 lekë. Më vonë ka rënë dakort, por me kusht që pagesën ta bënte më vonë. Në këto kushte subjekti sëbashku me bashkëshorten dhe shtetasin E.G kanë bërë dhënien hua.

Bazuar në faktin se, subjekti rezulton të ketë marrëdhënie financiare me shtetasin E.G, i cili në kuptim të ligjit konsiderohet person tjetër i lidhur, është kryer verifikim pranë Policisë së Shtetit, nga ku nuk rezultojnë të dhëna në ngarkim të shtetasit E.G.

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

Pasuria apartament me sip. 58.3 m², në Rr. "Irfan Tomini", Tiranë, në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes, është përfituar nga EKB në vitin 1997, me kontratë të përkohshme, ku janë paguar paradhënie 30.000 lekë. Në vitin 2007 është nënshkruar kontrata e shitblerjes, sipas së cilës, në datën 15.09.2006, janë paguar 830.486 lekë. Burimi i kësaj shume është kryesisht nga kredia e marrë nga bashkëshortja në Raiffeisen Bank. Totali i pagesave për apartamentin rezulton rreth 860.000 lekë. Banka konfirmon kredinë e marrë, shuma 500.000 lekë. Burimi

financiar për diferencën rreth 330.000 lekë, paguar në shtator 2006, janë të ardhurat e subjektit deklarues dhe bashkëshortes.

Apartamenti nuk ka qënë në përdorim deri në vitin 2014, kur subjekti dhe bashkëshortja kanë vendosur shitjen e tij, në shumën 3.000.000 lekë. Raiffeisen Bank konfirmon transaksionin e shitjes në vlerën 2.968.700 lekë si dhe shlyerje detyrimi në shumën 300.000 lekë nga shtetasi Elton Guçe.

Shuma e përfituar nga shitja e apartamentit, është përdorur pjesërisht për nevoja familjare dhe rreth 1.500.000 lekë janë përdorur për shlyerjen e kredisë në Procredit Bank.

- ✓ **Rezulton se pasuria apartament në Rr. Irfan Tomini, është përfituar me kontratë nga EKB, në shumën totale rreth 860.000 lekë dhe shitur në vitin 2014, në shumën 3.000.000 lekë.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi për shitjen e apartamentit me përgjigjen e ardhur nga Raiffeisen Bank dhe ASHK, e cila nuk e konfirmon pasurinë në emër të subjektit dhe bashkëshortes.**
- ✓ **Rezulton mospërputhje e shpjegimeve të dhëna nga subjekti në lidhje me vlerën e mobilimit të apartamentit, duke lënë të pashpjeguar dhe në kontradiktë vlerën 850.000 lekë të dhënë hua.**

13. Arë me sip. totale 1000 m2, Radhimë, Vlorë, blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. rep. ***, nr. kol. ***, datë 10.11.2006, në bashkëpronësi me 20 persona të tjerë. Vlera 2.000.000 lekë. Pjesa takuese 1/20 që përkon me shumën 100.000 lekë. Burimi i krijimit: Kursime familjare ndër vite.
Shitur në vitin 2016 pjesa takuese prej 1/20 prej 50 m2, në vlerën 600.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. rep. ***, nr. kol. ***, datë 10.11.2006, ku Zenel Hyka blen në bashkëpronësi arë me sip. 1.000 m2, në Radhimë, Vlorë, në vlerën 2.000.000 lekë. Zenel Hyka ka 1/20 pjesë takuese ose 100.000 lekë.

Hetimi Administrativ

- ✚ **ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë,** me postën elektronike datë 27.07.2023, ka përcjellë shkresën nr. *** prot, datë 25.07.2023, sipas së cilës, pas verifikimit të kryer në sistemin multifunksional të regjistrimit, është konstatuar se Zenel Hyka, Lindita Hyka, Elda Hyka dhe Erisa Hyka, nuk kanë pasuri të regjistruara në favor të tyre. Megjithatë, rezulton e regjistruar në favor të Zenel Hyka, pasuria e ndodhur në ZK *** me nr. ***, vol. ***, fq. ***, e llojit arë me sip. 500 m2, në të cilën subjekti ka qënë bashkëpronar me 1/18 pjesë. Me referencën e regjistrimit *** (në mungesë), subjekti i ka kaluar të drejtat e pronësise dhe nuk figuron më pronar i kësaj pasurie. Bashkëlidhur:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.2014, ku Zenel Hyka së bashku me bashkëpronarët e tjerë, blejnë tokë arë me sip. 500 m2, në vlerën 50.000 euro, ku secili bashkëpronar ka 1/18 pjesë takuese ose 2.777 euro.
- Certifikatë për vërtetim pronësie *****, datë 14.12.2016, për arë me sip. 500 m2, pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, Rradhimë, Vlorë, në bashkëpronësi sipas listës, ku figuron Zenel Hyka me 1/18 pjesë; Kartela e pasurisë.
- **Me inventarin datë 26.06.2023**, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave, për sip. toke 1.000 m2, kanë nënshkruar kontratë sipërmarrje me një ndërtues, por kur duheshin paguar kështu e ndërtimit, është detyruar të heqë dorë dhe të marrë shumën 600.000 lekë. Lidhur me destinacionin e përdorimit të kësaj shume, të cilën e ka marrë cash, sqaron se janë përdorur 300.000 lekë për shlyerjen e detyrimeve të shkollës së vajzave dhe 300.000 lekë për kompletimin e kuzhinës.

Subjekti paraqiti:

- Vërtetim nxjerrje nga arkiva noteriale, nr. rep. ***, datë 14.06.2023. Kontratë cedimi të drejtash pasurore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.02.2017, të përfituara nga Zenel Hyka me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 27.07.2013, në favor të përfituesit K.Ç. Prezent dhe jep pëlqimin shoqëria “****” shpk, me përfaqësues administratorin e saj E.A. Zenel Hyka ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes, në cilësinë e investitorit dhe bashkëpronarit në pjesë ideale prej 1/20 të pandarë të pasurisë arë me sip. 1000 m2 dhe 1/18 të pasurisë arë me sip. 500 m2, Radhimë, Vlorë. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Zenel Hyka heq dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet mbi këtë pasuri, duke i’ transferuar përfituesit të saj dhe njëkohësisht të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në kontratën e mësipërme.
- Certifikatë për vërtetim pronësie *****, datë 14.12.2016, për arë me sip. 1000 m2, pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, Radhimë, Vlorë, në bashkëpronësi sipas listës bashkëlidhur (lista nuk është bashkëlidhur).
- Certifikatë për vërtetim pronësie 1*****, datë 14.12.2016, për arë me sip. 500 m2, pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, Radhimë, Vlorë, në bashkëpronësi sipas listës bashkëlidhur (lista nuk është bashkëlidhur).
- Kontratë sipërmarrje nr. *****, datë 27.07.2013, me 15 palë pronarë dhe investitorë, ndërmjet të cilëve Zenel Hyka, dhe palë sipërmarrëse shoqëria “****” shpk. Objekti i kësaj kontrate, është ndërtimi nga sipërmarrësi i një objekti 4 katësh, të vendosur në një sip. toke arë prej 1000 m2 në Radhimë, Vlorë, e cila është në pronësi të përbashkët të porositësve. Certifikatë regjistrimi e personit të tatueshëm “****” shpk, me NIPT J66703214Ë. Licencë për kryerjen e punimeve të ndërtimit.
- **Në proces verbalin e datës 18.7.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaron se, pasi nuk arriti të financojë për ndërtimin e pjesës takuese dhe nuk pati mundësi financimi në marrëveshje me shoqërinë sipërmarrëse, paraprakisht ka bërë një prokurë të posaçme ku citohen këto fakte dhe njëkohësisht cakton si përfaqësues z. E.A, ndërtuesi, i cili në momentin e shitjes së pasurisë në bashkëpronësi, detyrohet t’i kthejë vlerën 500.000 lekë për blerjen e truallit dhe 2.777 euro, për shtesën e tokës prej 500 m2. Kontrata e shitjes për

kalimin e pjesës takuese të truallit, do të bëhej prej subjektit në momentin e marrjes së vlerës së mësipërme dhe më pas u realizua kontrata e cedimit të të drejtave.

Subjekti paraqiti:

- Prokurë e posaçme nr. *****, datë 11.11.2015, sipas së cilës, Zenel Hyka është në cilësinë e pronarit të truallit, në 1/20 pjesë ideale të pasurisë me sip. 1000 m², për të cilën kanë nënshkruar një kontratë sipërmarrje datë 27.07.2013, ku në cilësinë e palës pronare të tokës dhe investitore për ndërtimin e një strukture banimi, rezulton se pjesa takuese në sip. ndërtimore është ap. 1, në katin përdhe me sip. 54 m². Në këtë kontratë është rënë dakort që investimi do të kryhej me këste prej subjektit. Meqënëse nuk arriti të financojë për ndërtimin e pjesës takuese dhe nuk pati mundësi financimi, në marrëveshje me shoqërinë sipërmarrëse, me përfaqësuesin e saj, E.A, kanë rënë dakort që ky apartament të shitet prej ndërtuesit. Në cilësinë e pronarit të truallit, cakton si përfaqësues z. E.A, përfaqësues i shoqërisë “****” shpk, i cili ka të drejtë të nënshkruajë në emër të subjektit çdo lloj akti notarial, që lidhet me shitjen e apartamentit që do të përfitonte, të cilat, për shkak se investimi do të bëhet prej z. E.A, do të shiten prej tij. Në momentin e shitblerjes së apartamentit dhe truallit në bashkëpronësi, z. E.A, detyrohet t'i kthejë vlerën për blerjen e truallit prej 500.000 lekë dhe 2.777 euro për shtesën e tokës prej 500 m². Kontrata e shitjes për kalimin e pjesës së tij takuese të truallit, do të bëhet prej Zenel Hykës, në momentin e marrjes së vlerës së mësipërme.

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

Pasuria arë me sip. totale 1000 m², Radhimë, Vlorë, është përfituar me kontratë shitblerje në vitin 2006, ku pjesa takuese e subjektit ka qënë 1/20 ose 100.000 lekë, me burim kursime familjare ndër vite. Në vitin 2013, së bashku me bashkëpronarët e tjerë, është nënshkruar kontratë sipërmarrje për ndërtimin e një objekti 4 katësh të vendosur mbi këtë sip. toke, ku subjekti do të përfitonte sip. ndërtimi 54 m². Në vitin 2014 janë blerë edhe 500 m² sip. tokë në Radhimë, ku pjesa takuese e subjektit ka qënë 1/18 ose 2.777 euro. Në vitin 2015, për pamundësi financiare në investim nga ana e subjektit, në ndërtimin që do të kryhej nga ndërtuesi, subjekti ka lëshuar një prokurë të posaçme, sipas së cilës, ky i fundit detyrohet t'i kthejë shumën 500.000 lekë për blerjen e truallit dhe 2.777 euro për shtesën e tokës prej 500 m². Pas marrjes së këtyre vlerave, në vitin 2017 u bë kontrata për kalimin e pjesës takuese të pasurisë, në formën e kontratës së cedimit të të drejtave pasurore, duke hequr dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet mbi këtë pasuri dhe njëkohësisht të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në kontratën e sipërmarrjes. Shuma është deklaruar e marrë cash dhe është përdorur për shpenzime shkollimi të vajzave dhe 300.000 lekë për mobilim (kompletim kuzhine).

- ✓ **Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues, lidhur me tokën arë në Radhimë, Vlorë, blerë në vitin 2006 dhe vitin 2014.**
- ✓ **ASHK Vlorë nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të Zenel Hyka dhe personave të lidhur me të.**

14. Aktive afatgjata, materiale afatgjata: makineri dhe pajisje Baxho, punim ndërtimi, mjet transporti, të blera me kredi në vitin 2012 dhe 2013. Vlera 12.123.094 lekë. Aktualisht, aktiviteti me NIPT L2172123S, është mbyllur.

Hetimi Administrativ

✚ **Procredit Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 04.05.2023, konfirmon në emër të Zenel Hyka, ndër të tjera, kredi në shumën 15.500.000 lekë, data e hapjes 17.12.2012 dhe në shumën 4.500.000 lekë, data e hapjes 22.10.2012. Bashkëlidhur, nxjerrje llogarie ku evidentohet si vijon:

- Datë 22.10.2012, disbursim kredie në shumën 4.500.000 lekë:
 - Pagesa dogane datë 23.10.2012, shuma 583.189 lekë.
 - Tërheqje datë 27.10.2012 sipas njoftimit datë 26.10.2021, shuma 3.800.000 lekë.

- Datë 17.12.2012, disbursim kredie në shumën 15.500.000 lekë:
 - 310.000 lekë, datë 17.12.2012, pagesa komisioni.
 - 2.400.000 lekë, datë 03.04.2013, transfertë në Raiffeisen Bank Albania, SBFDF Frigo 09.
 - 2.107.500 lekë, datë 16.04.2013, konvertim në euro (debitim).
 - 3.571.240 lekë, datë 17.04.2013, konvertim në euro (debitim).
 - 2.396.948 leke, datë 29.04.2013, transfertë kombëtare dalëse në Raiffeisen Bank, Shnasi Invest shpk.
 - 564.800 lekë, datë 21.05.2013, konvertim në euro (debitim).
 - 1.763.750 lekë, datë 28.05.2013, konvertim në euro (debitim).
 - 703.000 lekë, datë 10.06.2013, konvertim në euro (debitim).
 - 705.000 lekë, datë 10.06.2013, konvertim në euro (debitim).
 - 1.500.000 lekë, datë 26.07.2013, tërheqje për blerje malli.
 - Likuidim faturash datë 12.02.2018, shuma 1.219.000 lekë, nga Albania Nesla për Z. Hyka PF.

✚ **QKB**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se Zenel Hyka i datëlindjes 02.01.1962, me numër personal ***, figuron të jetë i regjistruar si person fizik nga data 21.05.2012, me emrin "Zenel Hyka", pajisur me NUIS (NIPT) L21721023S. Statusi i subjektit është aktiv. Bashkëlidhur ekstrakti historik, sipas të cilit data e regjistrimit është 21.05.2012, fusha e veprimtarisë "*Fermë për mbarështim bagëtitsh dhe import i tyre, import i pajisjeve të nevojshme për mbarështimin e tyre (bujqësore dhe blegtorale), import pajisje për përpunimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe gjithë llojet e ushqimit për mbarështimin e kafshëve*". Vendi i ushtrimit të aktivitetit: Petrelë, Barbas, Tiranë. Objekt 1 kat, pranë Lagjja "Hyka". Nga kontrolli i të dhënave të publikuara në Regjistrin Kombëtar të Licencave, lejeve dhe Autorizimeve të administruar në QKB, rezulton se nuk rezultojnë leje/licenca të lëshuara.

✚ **DRT Tiranë**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.05.2023, konfirmon se sipas të dhënave në sistemin tatimor c@ts, rezulton Zenel Hyka, i regjistruar si person fizik me NIPT L21721023S, më datë 21.05.2012, me aktivitet "Fermer për mbarështim bagëtish".

- **Me inventarin datë 26.06.2023**, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave:
 - Procredit Bank është banka që krediton fermerët. Lidhur me vlerën e deklaruar të asetëve, sqaron se janë blerë gjatë viteve 2012 e 2013 dhe kanë qënë në punë deri në vitin 2019. Gjatë viteve ato janë amortizuar. Aktivet biologjike, në vitin 2015 janë vlerësuar në vlerën 5.657.800 lekë, kjo sipas deklaratës doganore datë 23.10.2012. Në vitin 2018, vlera ka zbritur në 1.300.000 lekë.
 - Lidhur me transaksionet e konfirmuara nga Procredit Bank, sqaron se kredia është përdorur vetëm në funksion të Fermës.
 - Lidhur me vendin e ushtrimit të aktivitetit, sqaron se fshati Barbas është vendlindja e tij, ku ka banuar deri në vitin 1998 (duke zbritur vitet që ka shërbyer në qytetin e Ersekës). Aktiviteti i fermerit, ka qënë i trashëguar si punë në fshat dhe bazuar në rregullat për formalizimin e bujqësisë, është regjistruar në QKB. Aktiviteti është kryer në një godinë të ndërtuar në mënyrë informale, ku janë bërë investimet e duhura, duke e përshtatur për baxho. Vlerat monetare për ndërtimin e Baxhos janë siguruar nga kredia në Procredit Bank. Punimet janë kryer nga "Shansi Invest" shpk, sipas faturave dhe situacioneve përkatëse.
 - Lidhur me statusin e aktivitetit në QKB, sqaron se më datë 02.04.2019, biznesi ka kaluar në status "Pezulluar". Për shkak të nevojës për një transaksion financiar, është bërë riaktivizimi dhe më datë 17.10.2019, është bërë aplikimi për pezullim. Pasi ka kontaktuar me DRT Tiranë, është njohur me detyrimet, kjo për shkak të mos deklarimeve nga data që kishte aplikuar për pezullimin e aktivitetit. Thekson se në DRT Tiranë, aktiviteti rezulton "Pasiv" (pasi nuk ka aktivitet). Më datë 16.06.2023, ka bërë likuidimin e detyrimeve dhe më pas, pas shuarjes në sistem, ka bërë aplikimin për pezullimin e tij. Aktualisht statusi i aktivitetit është "Pasiv".
 - Lidhur me kryerjen e aktivitetit në vitin 2012, sqaron se ka marrë edhe dakortësinë e strukturës përkatëse.

Subjekti paraqiti:

- Letër angazhimi dhe opinion i Auditit Ligjor, Lavdim Musaj, datë 15.06.2023, ku ndër të tjera citohet se, përputhshmëria e inventarit të aktiveve afatgjatë materiale (jo biologjike), është e përputhur me shifren në aktiv të bilancit. Bashkëlidhur inventari i aktiveve të qëndrueshme afatgjata, amortizimi i tyre në vite dhe vlera e mbetur deri në 31.12.2022, rreth 12.986.000 lekë, me shënimin se pas vitit 2019, aktivet u konservuan. Libri i shitjeve për vitin 2018.
- Certifikatë regjistrimi me nr. Serial ***, NIPT L21721023S, adresa Barbas, "Stallë 1 kat", pranë L. Hyka.
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e Fermerit Zenel Hyka.
- Licence nr. ***, për "mbarështimin e kafshëve në fermat agrolektorale".
- Licence nr. ***, për "Prodhim dhe tregtim të nënprodukteve të qumështit".
- Leje nr. ***, për ndikimin në mjedis.

- Ekstrakt i QKB, datë printimi 30.09.2019, ku figuron se në datë 03.04.2019, statusi i subjektit është pezulluar dhe në datë 27.09.2019 është bërë aktiv.
- Formular aplikimi datë 17.10.2019, për pezullim aktiviteti, marrë me shkresë të QKB nr. ***, datë 13.6.2023.
- E-Tax Shqipëri, tatim paguesi Zenel Hyka, PF, statusi i aktivitetit është "Pasiv".
- Formular aplikimi datë 22.06.2023, për pushimin e përkohshëm të aktivitetit.
- Shkresë nr. ***, datë 06.06.2012, nga Drejtoria e Standardeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Pajisje Ftohëse Frigoriferike + Dhoma Frigoriferike: Faturë nr. ***, datë 29.06.2013, Montini SRLOsimo, me vlerë 12.500 Euro, deklaratë doganore datë 06.07.2013, për këtë faturë; Faturë tatimore Shitje të SBFDFRIGO me nr. Serie ***, datë 02.04.2013 dhe nr. Faturë **, në vlerën 2.400.000 lekë.
- Pajisje të përpunimit të qumështit dhe pajisje për stallën: Dokument nr. ***, datë 30.04.2013, Gkioka Effrosyni Xrysoula Selanik dhe Tanusi, me vlerë 25.773 Euro, deklaratë doganore datë 02.05.2013; Dokument F&G - Fushë Kosovë nr. ***, datë 18.04.2013, me vlerë 5.200 Euro; Dokument nr. ***, datë 17.04.2013, "Qumështore Sharri" - Prizeren, me vlerë 14.000 Euro, deklaratë doganore datë 01.06.2013; Faturë e SERDAR AKARSU, Turqi me vlerë 20.600 euro, deklaratë doganore datë 01.07.2013.
- Deklaratë doganore e blerjes së deleve, datë 23.10.2013, me vlerë 2.915.952 lekë + 583.189 lekë taksa.
- Punime Ndërtimi: Faturë Tatimore Shitje nr. Serie *** dhe nr. Faturë ***, datë 29.04.2013, Shansi Invest shpk; Situacion Punimesh me vlerë 2.396.948 lekë; Faturë Tatimore Shitje nr. Serie *** dhe nr. Faturë **, datë 30.05.2013, Shansi Invest shpk.; Situacion Punimesh me vlerë 3.964.863 lekë.
- Deklaratë doganore e blerjes së deleve datë 23.10.2013, me vlerë 2.915.952 lekë + 583.189 lekë taksa.

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se;

Pasuria aktive afatgjata + materiale, është përfituar në vitin 2012 dhe 2013 me burim kredi bankare. Procredit Bank, konfirmon kreditë e marra në vitin 2012 dhe 2013, si dhe transaksionet përkatëse të cilat janë dokumentuar nga subjekti, në funksion të fermës. QKB dhe organet tatimore konfirmojnë regjistrimin më datë 21.05.2012, me aktivitet "Fermer për mbarështim bagëtitish". Asetet janë amortizuar ndër vite dhe prej vitit 2019 janë konservuar, pasi aktiviteti i fermerit nuk ushtrohet më. Vlera e dokumentuar deri në fund të vitit 2022, rezultojnë rreth 12.986.000 lekë. Aktualisht, janë në proces vendimmarrje nëse do të shiten apo jepen me qira.

- ✓ **Konfirmohet aktiviteti i fermerit dhe kreditimi bankar nga Procredit Bank, QKB dhe organet tatimore. Vlera e dokumentuar e aseteve deri në 31.12.2022, rreth 12.986.000 lekë.**

DEKLARIMI I TE ARDHURAVE

1. 01.09.1985 - 31.08.1988. Specialist veshmbathje në Degën e Punëve të Brendshme, Ersekë. Shuma 24.550 lekë.
2. 01.09.1988 - 15.10.1990. Studime Pasuniversitare në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë (për llogari të M. Brendshme). Shuma 18.550 lekë.
3. 16.10.1990 - 15.7.1991. Shef Prapavije, në Shkollën e Lartë të MPB. Paga, shpërblime, dieta. Shuma 8.410 lekë.
4. 16.07.1991 - 31.07.1992. Specialist i pajisjeve në Drejtorinë Ekonomike, MPB. Paga, shpërblime, dieta. Shuma 10.550 lekë.
5. 01.08.1992 - 31.08.1993. Specialist veshmbathje dhe kazermimit, Drejtoria e Policisë Tiranë. Paga, shpërblime, dieta. Shuma 49.000 lekë.
6. 01.09.1993 - 30.11.1996. Shef i Sektorit Ekonomik, në Komisarjatin e Policisë nr.2, Tiranë. Paga, nuk janë vendosur shpërblime e dieta. Shuma 319.100 lekë.
7. 01.12.1996 - 28.02.1998. Komandant i Repartit 100, Mullet, Tiranë. Paga, shpërblime, dieta. Shuma 296.040 lekë.
8. 01.03.1998 - 15.05.2001. Specialist në Zyrën e Intendencës në Drejtorinë Ekonomike, MB, Drejtoria e Policisë Tiranë. Paga, nuk janë vendosur shpërblime e dieta. Shuma 664.722 lekë.
9. 01.07.2001 - 31.05.2005. Specialist dhe shef zyre page, nuk janë vendosur shpërblime e dieta. Shuma 1.431.252 lekë.
10. Përmbledhëse e pagave nga viti 2005 - 2018; Kam punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si specialist, shef zyre dhe shef sektori. Vetëm në periudhën 17.02.2015 - 07.06.2015, kam punuar shef i Sektorit Ekonomik, Drejtoria e Policisë Durrës. Urdhër i revokuar dhe rikthyer në detyrën që kam qënë. Gjatë periudhës 2005 - 2018, sipas dokumentit të lëshuar nga Raiffeisen Bank, më datë 12.04.2018, shuma e kreditimit është 17.862.600 lekë, nga të cilat 2.968.700 lekë janë nga shitja e apartamentit në Rr. "Irfan Tomini", në vitin 2014 dhe 14.893.950 lekë nga paga dhe shpërblime.
11. Të ardhura nga paga, periudha 01.01.2008 - 31.12.2022. Shuma 5.956.456 lekë.
12. Të ardhura nga paga, periudha janar - shkurt 2023. Shuma 234.000 lekë.
13. Për periudhën 2012 - 2018, me kredinë e marrë në Procredit Bank, kam ushtruar një aktivitet privat, "Për mbarështimin e bagëtive të imëta dhe përpunim qumështi e nënprodukteve të tij" me NIPT L21721023S, aktivitet i cili është i mbyllur. Me të ardhurat e siguruara nga ky aktivitet, është mundësuar shlyerja e pjesshme e kredisë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim page, datë 07.03.2023, nga e-albania, periudha janar - dhjetor 2018, paga neto 88.197 lekë.
- Vërtetim page, datë 07.03.2023, nga e-albania, periudha janar - dhjetor 2019, paga neto 87.359 lekë.
- Vërtetim page, datë 07.03.2023, nga e-albania, periudha janar - dhjetor 2020, paga neto 87.359 lekë.
- Vërtetim page, datë 07.03.2023, nga e-albania, periudha janar - gusht 2021, paga neto 87.090 lekë; shtator - tetor 2021, paga neto 93.816 lekë; nëntor 2021, paga neto 193.906 lekë dhe dhjetor 2021, paga neto 115.366 lekë.

- Vërtetim page, datë 07.03.2023, nga e-albania, periudha janar - prill 2022, paga neto 93.816 lekë; maj 2022, paga neto 96.648 lekë; qershor 2022, paga neto 106.324 lekë; korrik - gusht 2022, paga neto 116.965 lekë; shtator 2022, paga neto 155.163 lekë; tetor 2022, paga neto 119.137 lekë dhe nëntor 2022, paga neto 285.480 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., shtator 2022, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Sektori i Financës, ku Zenel Hyka, me detyrë Drejtor në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse, paguhet me pagë mujore bruto në shumën 157.500 lekë dhe neto 116.965 lekë. Të ardhurat paga, shpërblime, veshmbathje etj, për periudhën janar - dhjetor 2022, janë në shumën neto 1.505.075 lekë.
- Pasqyra përmbledhëse e pagave për periudhën janar 2018 - dhjetor 2022, shuma neto 5.956.456 lekë.

Hetimi Administrativ

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, në emër të Zenel Hyka, ku evidentohen kreditimet e pagave prej muajit mars 2005. Për periudhën janar 2006 - mars 2023, subjekti ka përfituar të ardhura nga paga, shpërblime, veshje, dieta, honorare etj., në shumën totale rreth 20.212.000 lekë.
- ✚ **DPT**, me shkresën nr. *** prot, datë 12.05.2023, konfirmon se Zenel Hyka, me NIPT L21721023S, është tatim pagues në DRT Tiranë, si person fizik.
- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, konfirmon (pagat bruto dhe neto) periudha kontributive janar 2012 - mars 2023, të Zenel Hyka, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, si dhe nga Zenel Hyka me NIPT L21721023S.
Me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, i drejtohet Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të përcjellë informacionin e kërkuar për periudhën para vitit 2012.
- ✚ **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresën nr. *** prot, datë 17.05.2023, informon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listpagesave për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet shtetërore juridike apo fizike, nuk mund të konfirmohen periudha kontributive apo paga mbi të cilën këta subjekte janë siguruar, në qoftë se nuk jepet dokumentacioni përkatës nga ana e subjektit kërkues lidhur me emërtimin e qëndrës së punës, Nipt-in e subjektit, fotokopje e librezës së punës, etj. Bashkëlidhur vërtetim nr. *** prot, datë 12.05.2023, për vjetërsinë në punë për efekt pensioni të Zenel Hyka, nd/ja pyjore, Tiranë, stazhier 02.10.1981 - 22.08.1982.
- ✚ **DRT Tiranë**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.05.2023, konfirmon se, sipas të dhënave në sistemin tatimor c@ts, rezulton Zenel Hyka, i regjistruar si person fizik me NIPT L21721023S, më datë 21.05.2012, me aktivitet "Fermer për mbarështim bagëtish". Të ardhurat e deklaruara sipas të dhënave të deklaratave të dorëzuara në sistemin c@ts, janë si vijon:

| Viti | Qarkullimi | Fitimi | Humbja | Fitimi pas tatimit |
|------|------------|--------|---------|--------------------|
| 2012 | | | 237.909 | |

| | | | | |
|--------|------------|-----------|-----------|-----------|
| 2013 | | - | - | |
| 2014 | 5.360.965 | | 1.259.554 | |
| 2015 | 2.960.816 | | 1.344.967 | |
| 2016 | 4.532.383 | 331.396 | | 331.396 |
| 2017 | 5.298.500 | 39.832 | | 39.832 |
| 2018 | 2.709.583 | 1.133.878 | | 1.133.878 |
| 2019 | | | | - |
| 2020 | | | | - |
| Totali | 19.862.247 | | | 1.505.106 |

Është person fizik dhe nuk shpërndan dividend, pasi bazuar në nenin 5.6, “Vendim për destinimin e fitimit”, të UMF, nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, subjekti nuk ka detyrim të depozitohet pranë administratës tatimore, vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë, lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, pasi është person fizik. Ky subjekt ka detyrime të papaguara në vlerën 85.320 lekë.

- **Me inventarin datë 26.06.2023**, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave:
 - Lidhur me konfirmimin nga DRT Tiranë, për të ardhurat nga aktiviteti si fermer, sqaron se mbarështimi i bagëtive është shumë i vështirë dhe pothuajse ishte e pamundur të fitohej më shumë, se sa me xhirot mujore, e të kishe mundësi të shlyeje kredinë. I gjithë aktiviteti ishte i fokusuar në mbarështimin e bagëtive, ku në çdo moment mund t'i rrezikohesh shëndeti. Në këto kushte, edhe ato të ardhura që janë fituar, i kanë shërbyer këtij objekti.
 - Lidhur me konfirmimin e ISSH, për periudhë kontributive si person fizik, sqaron se nuk ka marrë pagë nga aktiviteti si fermer, prej vitit 2015 dhe në vazhdim.

Me inventarin date 5.7.2023, subjekti ka paraqitur:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 30.06.2023, nga Akademia e Sigurisë, sipas të cilit Zenel Hyka, ka përfiturar të ardhura për periudhën 01.09.1990 - 31.12.1990, pagë neto 2.800 lekë dhe 01.01.1991 - 16.07.1991, paga neto 5.452 lekë. Shuma 8.252 lekë.
- Shkresë kthim përgjigje nr. ***, datë 04.07.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, sipas së cilës nuk disponojnë listpagesa, për periudhën 01.08.1992 - 31.10.1993; 01 - 15.11.1993; 01 - 15.12.1993; 16 - 31.05.1994; 01.07.1994 - 31.12.1994; 01.01.1995 - 31.12.1995; 01.01.1996 - 30.04.1996 dhe 16.05.1996 - 30.11.1996. Bashkëlidhur pasqyra përmbledhëse, e të ardhurave nga paga për periudhën gusht - dhjetor 1992, shuma neto 18.035 lekë; viti 1993, shuma neto 57.945 lekë; viti 1994, shuma neto 92.998 lekë + shpërblime 15.290 lekë; viti 1995, shuma neto 110.325 dhe viti 1996, shuma neto 111.906 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 03.07.2023, nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, sipas të cilit Zenel Hyka, ka përfiturar të ardhura nga paga për periudhën korrik - dhjetor 1991, në shumën 6.490 lekë; janar - gusht 1992, në shumën 13.776 lekë; mars - dhjetor 1998, në shumën neto 168.230 lekë; viti 1999, shuma 215.568 lekë; viti 2000, shuma 238.440 lekë dhe janar - korrik 2001, shuma 143.091 lekë. Totali 785.595 lekë.

- Vërtetim nr. *** prot., datë 03.07.2023, nga Departamenti për Shërbimet Mbështetëse, sipas së cilit Zenel Hyka, ka përfituar në vitin 1996, pagë mujore bruto në shumën 16.532 lekë dhe në vitin 1997, në shumën 16.532 lekë. Të ardhurat në vitin 1997, llogariten në shumën bruto 198.384 lekë ose neto 111.906 lekë (sa konfirmimi për pagën neto të vitit 1996, në shkresën e mësipërme nr. ***, datë 04.07.2023).
- Vërtetim nr. *** prot. datë 29.06.2023 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, sipas së cilit Zenel Hyka, ka përfituar të ardhura nga pagat për periudhën korrik – dhjetor 2001, shumën neto 190.635 lekë; vitin 2002, shumën neto 444.057 lekë; vitin 2003, shumën 577.279 lekë, vitin 2004, shumën neto 673.564 lekë dhe për vitin 2005, shumën neto 667.897 lekë.
- ✓ **Të ardhurat e subjektit nga pagat, shpërblime, etj., për periudhën shtator 1990 - mars 2023, rezultojnë rreth 24.077.000 lekë, konfirmuar me dokumentacionin e dorëzuar dhe nga sistemi bankar.**
- ✓ **Qarkullimi total nga aktiviteti i fermerit, konfirmuar nga organet tatimore, për periudhën 2012 - 2019, rezulton rreth 19.862.000 lekë, ndërsa fitimi pas tatimit rreth 1.505.000 lekë.**
- ✓ **Të ardhurat në shumën 3.000.000 lekë nga shitja apartamentit në Tiranë, janë trajtuar më sipër në rubrikën përkatëse të pasurive të subjektit të deklarimit.**

DETYRIME FINANCIARE

14. Huamarrje në shumën 2.500.000 lekë, ndaj motrës sime, Z.M. Burimi i krijimit, janë të ardhurat nga shpronësimi i pronës së saj në Mullet, Tiranë. Huaja është marrë në kushtet e mirëbesimit, pa kontratë noteriale. Qëllimi: shlyerja e kredisë në Procredit Bank. Detyrimi financiar i mbetur 2.500.000 lekë.

Hetimi Administrativ

- **Me inventarin datë 26.06.2023,** të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave për nevoja të shlyerjes së kredisë në Procredit Bank, në fund të vitit 2017, i ka marrë hua në shumën 2.500.000 lekë motrës, Z.M, e cila jeton bashkë me djalin e saj, A.M. Burimi i kësaj shume, ishte shpronësimi i pronës në Mullet, Tiranë, ku është ndërtuar superstrada Tiranë - Elbasan. Shlyerja e huasë, nuk është bërë për pamundësi ekonomike. Nipi, djali i Z.M, është edhe një nga garantorët në marrjen e kredisë në Procredit Bank. Detyrimi do të kthehet kur të jetë shlyer kredia dhe të shesin pajisjet dhe pronën.

Subjekti paraqiti:

- VKM nr. ***, datë 07.12.2016, “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë - Elbasan (shitesa)”.
- Lista e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit të segmentit rrugor Tiranë - Elbasan (shitesa), ku nr. 1 figuron Z.M, vlera 114.513 lekë; bashkëpronarët M, shuma

3.869.076 lekë dhe 8.808.000 lekë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës, Autoritetit Rrugor.

- Statement bankar nga Raiffeisen Bank, për llogari në emër të A.M, ku figuron se në datë 26.10.2017, ka tërhequr shumën 2.800.000 lekë.
- **Në proces verbalin e datës 18.7.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaron se motra ka përfituruar, si individualisht, ashtu edhe sipas listës së bashkëpronarëve M, të cilët kanë përfituruar në mënyrë të barabartë. Shuma 2.800.000 lekë, në llogarinë e A.M, është me burim nga shpronësimet e nënës së tij, i cili ka qënë i autorizuar me prokurë për përfaqësimin e familjes.

Me inventarët e datave 05.07.2023 dhe 26.06.2023, subjekti ka paraqitur:

- Deklaratë nga Z.M (Hyka), sipas të cilës, më datë 14.12.2017, i ka dhënë vëllait të saj, Zenel Hyka, shumën 2.500.000 lekë, e cila buron nga shpronësimi i pronës në Mullet, Tiranë, bazuar në VKM nr. 861, datë 07.12.2016. Lekët janë dhënë për nevoja të shlyerjes së kredisë bankare në Procredit Bank. Paratë janë tërhequr nga Raiffeisen bank, nga djali, A.M. Huaja do të kthehet pas shlyerjes së kredisë, heqjes së tokave nga kolaterali dhe në vijim, shitjes së pronës. Deklarata është firmosur edhe nga A.M.
- Shkresë nr. *** prot., datë 07.06.2017, nga ARSH "Dërgim listpagese", drejtuar Ministrisë së Financave, sipas të cilës në zbatim të VKM, nr. 861, datë 07.12.2016, dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 7, datë 07.05.2017, kërkohet të bëhet pagesa e pronarëve sipas listës bashkëngjitur, në shumën 2.801.076 lekë. Sqarohet se pagesa në favor të A.M, bëhet e bazuar në prokurën ku autorizohet nga bashkëpronarët për tërheqjen e shumës së shpronësimit.
- Listpagesë për shpronësimet në emër të A.M, shuma 2.801.076 lekë.
- Prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.05.2017, ku Z.M, A.M dhe K.M, emërojnë A.M si përfaqësues të tyre, lidhur me procedurat e shpronësimit të pasurisë nr. ***, zk ***, (përfshirë vlerat monetare), prekur nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë - Elbasan. Dokumentacioni i pronësisë së pasurisë në emër të Z.M, A.M, K.M dhe A.M

Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojn se;

Huaja në shumën 2.500.000 lekë, është marrë në muajin dhjetor të vitit 2017, me qëllim shlyerjen (pjesërisht) të kredisë në Procredit Bank. Burimi i kësaj shume nga huadhënësi, që është motra e subjektit, janë të ardhurat e përfituara nga shpronësimet publike; subjekti ka dokumentuar si përfitim individual të motrës, ashtu edhe në bashkëpronësi, në shumën totale rreth 12.792.000 lekë. Gjithashtu, është dokumentuar përfitimi i shumës 2.800.000 lekë nga A.M, djali motrës, i cili ka qënë njëkohësisht edhe personi i autorizuar me prokurë për përfaqësimin e familjes M, në procesin e shpronësimit publik, shumë e cila është tërhequr në muajin tetor të vitit 2017.

Prej vitit 2017, për pamundësi ekonomike, nuk është kryer asnjë shlyerje. Detyrimi do të kthehet kur të jetë shlyer kredia dhe të shesin pajisjet.

- ✓ **Deklarimi bazohet në dokumentacionin e dorëzuar. Detvrimi në shumën 2.500.000 lekë ndaj motrës, do të kthehet kur të jetë shlyer kredia dhe të shiten pajisjet.**

15. Kredi bankare në Raiffeisen Bank, për ristrukturimin e kredisë në Procredit Bank, nga data 15.11.2017. Shuma totale 1.000.000 lekë, afati 60 muaj. Aktualisht është e shlyer.

Hetimi Administrativ

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie ku evidentohet se Zenel Hyka, në datë 15.11.2017, ka marrë kredi në shumën 1.000.000 lekë.

✚ **Procredit Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 04.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie në emër të Zenel Hyka, ku figuron se gjatë periudhës nëntor - dhjetor 2017, janë paguar këste kredie në shumën totale rreth 908.000 lekë.

Me inventarin e datës 05.07.2023, subjekti ka paraqitur:

➤ Kontratën e kredisë bankare me Raiffeisen Bank, në shumën 1.000.000 lekë. Kredimarrës Zenel Hyka, afati 60 muaj.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank, për kredi në shumën 1.000.000 lekë.**

16. Overdraft në Raiffeisen Bank me limit 160.000 lekë, i papërdorur. Detyrimi i mbetur 0 lekë.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon overdraft në shumën 160.000 lekë, çelur më datë 04.07.2014.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Raiffeisen Bank.**

17. Kredi bankare në Procredit Bank, marrë më datë 22.10.2012, për investimin e bërë në ndërtimin dhe funksionimin e baxhos në vitin 2012. Shuma 4.500.000 lekë + 15.000.000 lekë, totale 19.500.000 lekë, e strukturuar disa herë dhe e fundit ristrukturuar në shumën 4.722.623 lekë, më datë 31.08.2021. Kohëzgjatja 84 muaj. Garantorët: Xh.H, vëllai, si bashkëpronar me tokat; A.E, i njohur i familjes dhe A.M, nipi (djali i motrës). Detyrimi i mbetur më datë 08.03.2023, në shumën 3.829.870 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

➤ Plan pagesa Aneksi 1, nga Procredit Bank, periudha gusht 2021 - shtator 2022, shuma e kredisë 4.722.623 lekë, interesi 7.33%, kësti mujor 71.566 lekë. Për periudhën shtator 2021

- mars 2023, llogariten këste të paguara me vlerë 71.566 lekë ose për 18 muaj, rreth 1.288.000 lekë.
- Marrëveshje për ndryshimin e kontratës së kredisë (ristrukturim kredie), datë 31.08.2021, kredi dhënës Procredit Bank dhe kredi marrës Zenel Hyka. Kredia ristrukturohet në vlerën 4.722.623 lekë, me afat 84 muaj.

Hetimi Administrativ

🚩 **Procredit Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 04.05.2023, konfirmon në emër të Zenel Hyka, kredi në shumën e ristruktuar prej 4.722.623 lekë dhe detyrim të mbetur në shumën 3.903.315 lekë. Konfirmohet gjithashtu:

- Kredi në shumën 13.826.515 lekë, data e hapjes 12.08.2014 dhe data e mbylljes 09.10.2019.
- Kredi në shumën 15.500.000 lekë, data e hapjes 17. 12.2012 dhe data e mbylljes 12.08.2014.
- Kredi në shumën 3.000.000 lekë, data e hapjes 30.12.2015 dhe data e mbylljes 13.02.2018.
- Kredi në shumën 4.500.000 lekë, data e hapjes 22.10.2012 dhe data e mbylljes 12.08.2014.
- Linjë kredie në shumën 3.000.000 lekë, data e hapjes 13.08.2014 dhe data e mbylljes 30.09.2015.
- Linjë kredie në shumën 3.000.000 lekë, data e hapjes 30.09.2015 dhe data e mbylljes 30.12.2015.
- Linjë kredie në shumën 3.000.000 lekë, data e hapjes 24.07.2013 dhe data e mbylljes 13.08.2014.
- Theksohet se Zenel Hyka është debitor solidar për: kredi në shumën 15.500.000 lekë, disbursuar më datë 17.12.2012, me statusin e mbyllur; kredi në shumën 4.500.000 lekë, disbursuar më datë 22.10.2012, me statusin e mbyllur; linjë kredie në shumën 3.000.000 lekë, disbursuar më datë 24.07.2013 me statusin e mbyllur.

Bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet si vijon:

- Datë 17.12.2012, disbursim kredie në shumën 15.500.000 lekë:
- Datë 22.10.2012, disbursim kredie në shumën 4.500.000 lekë:
- Subvencion nga AZHBRR, datë 21.06.2013, shuma 947.934 lekë, për normën e interesit të kredisë për 6 M/II/2012 dhe 6 M/1/2013; shuma 887.700 lekë, 6 M/II/2013, datë 27.11.2013; shuma 836.642 lekë, 6 M/1/2014, datë 30.06.2014; shuma 725.986 lekë, 6 M/II/2014, datë 16.12.2014; shuma 667.126 lekë, datë 23.12.2015; shuma 651.778 lekë, datë 02.08.2016; shuma 554.221 lekë, datë 06.01.2017.
- **Me inventarin datë 26.06.2023**, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave:
 - Procredit Bank është banka që financon fermerët. Kredia është marrë bazuar në kontratën për kreditim me kusht nr. *** rep., *** kol, datë 17.10.2012 dhe shtesës për kreditim me kusht dhe hipotekimi datë 24.07.2013, lidhur midis palëve dhe brenda shumës limit 23.000.000 lekë.

- Lidhur me transaksionet e konfirmuara, sqaron se kredia është përdorur vetëm në funksion të Fermës. Gjatë vitit 2012 – 2017, për normën e interesit të kredisë ka kontribuar edhe AZHBR, si ndihmë për fermerët dhe politikë për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë së qeverisë shqiptare, politikë që vazhdon të implementohet edhe sot. Këto politika i ka edhe banka që financon për bujqësinë, pasi është kreditim me risk të lartë.
- Lidhur me burimet financiare të përdorura për shlyerjet e kredisë ndër vite, sqaron se kredia është shlyer nga xhirot mujore të aktivitetit si fermer, shitja e apartamentit, huaja e marrë nga motra dhe kursimet. Me punën e kryer, kanë arritur të shlyejnë një pjesë të kredisë dhe tani janë në vendimmarrje, nëse do të shitet apo do të jepet me qira.

Subjekti paraqiti:

- Letër angazhimi dhe opinion i Auditit Ligjor, L.M, ku ndër të tjera citohet se vlera kontabël e asetëve është shumë më e lartë se detyrimi për kredi. Gjithashtu, edhe vlera e pronave të trashëguara, të cilat janë vendosur si kolateral për bankën lidhur me kredinë e marrë, është rritur shumë dhe mund të shlyejnë detyrimin ndaj saj.
- Kontratë për kreditim me kusht dhe hipotekimi nr. *** rep., *** kol, datë 17.10.2012, deri në shumën 20.000.000 lekë. Kreditori Zenel Hyka, person fizik, plus praktika.
- Shtesë kontrate për kreditim me kusht dhe hipotekimi datë 24.07.2013, deri në shumën 23.000.000 lekë. Kreditori Zenel Hyka, person fizik, plus praktika, përfshirë aktet e pronësisë të lëna koleteral.
- Aprovimi i limitit të kredisë deri në 20.000.000 lekë, në emër të Zenel Hyka si PF, me shënimin se klienti po financohet për blerjen e pajisjeve për përpunimin e qumështit dhe blerjen e deleve sipas ofertave.
- Formular i pranimit të aplikimit, AZHBRR; Formular i aplikimit datë 26.06.2012, lidhur me subvencionimin e normës së interesit në përputhje me skemat mbështetëse për vitin 2012, për fermerët.

Në deklarin e tij Z. Zenel Hyka, konfirmuar edhe me kontratën për kreditim me kusht, shprehet se një nga garantorët e kësaj kredie është shtetasi A.E, me të cilin nuk ka lidhje familjare por lidhje miqësore. Në kushtet kur marrëdhënia financiare midis subjektit dhe shtetasit A.E, si garantor, nuk është konsumuar, pasi kredia e marrë nga subjekti është në vijimësi të pagesave të kësteve, nuk është bërë një hetim i thelluar i mundësive financiare për shtetasin në fjalë.

Pavarësisht kësaj, është kryer verifikim pranë Policisë së Shtetit nga ku nuk rezultojnë të dhëna në ngarkim të shtetasit A.E.

Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se;

Kredia në shumën totale prej 20.000.000 lekë, i është akorduar subjektit në cilësinë e personit fizik si fermer dhe është disbursuar me dy këste në vitin 2012. Kredia është përdorur totalisht në funksion të aktivitetit të fermerit dhe shuma është ristruktuar ndër vite. Procredit Bank, konfirmon kreditë dhe ristrukturimet përkatëse. Ristrukturimi i fundit është bërë në muajin

gusht 2021, në shumën e mbetur prej 4.722.623 lekë, ku kredimarrës është subjekti, Zenel Hyka. Burimet financiare për shlyerjen e kredisë, kanë qënë xhirot mujore të aktivitetit si fermer, shitja e apartamentit, huaja e marrë nga motra dhe kursimet. Gjithashtu, norma e interesit është subvencionuar nga AZHBR, në përputhje me skemat mbështetëse për fermerët.

- ✓ **Procredit Bank konfirmon detyrimin e mbetur për kredi, në shumën 3.903.315 lekë. Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me përfitimin e kredisë, si dhe transaksionet e konfirmuara nga banka.**
- ✓ **Për periudhën shtator 2021 - mars 2023, sipas dokumentacionit të paraqitur, llogariten shpenzime për pagesat e kësteve të kredisë në Procredit Bank, në shumën totale rreth 1.288.000 lekë.**
- ✓ **Dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me burimet financiare të përdorura për shlyerjet e kredisë në Procredit Bank; xhirot mujore të aktivitetit si fermer, shitja e apartamentit në Rr. Irfan Tomini, huaja e marrë nga motra dhe kursimet familjare, janë trajtuar në rubrikat përkatëse të deklarimit të subjektit.**

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

- ❖ **Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.**

18. Për vitin 2022 për ujë, energji, internet dhe telefon, kemi shpenzuar 263.201 lekë.

- Shpenzime për ujë, janar - dhjetor 2022 = 44.961 lekë.
- Shpenzime për energji, janar - dhjetor 2022 - 145.040 lekë.
- Shpenzime për internet, janar - dhjetor 2022 = 15.040 lekë.
- Shpenzime për mobile telefon, janar - dhjetor 2022 = 58.200 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Pasqyrë përmbledhëse e shpenzimeve për ujë, energji, telefon për vitin 2022, shuma totale 263.201 lekë.
- Kopje e librezës së pagesës së energjisë elektrike, nr. kontrate ***, TR2, në emër të Zenel Hyka. Shuma e pagesave janar - dhjetor 2022, rreth 145.000 lekë.
- Kopje e librezës së pagesës së ujit, nr. kontratë ***, në emër të Zenel Hyka. Shuma e pagesave janar - dhjetor 2022, rreth 44.960 lekë.

Hetimi Administrativ

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie në emër të Zenel Hyka, ku për vitin 2022, evidentohen pagesa për llogari të Vodafone.

✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot, datë 09.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie në emër të Lindita Hyka, ku për periudhën prill - dhjetor 2022, evidentohen pagesa për rimbushje celulari.

✚ **FSHU**, me shkresën nr. *** prot, datë 18.05.2023, konfirmon se me generalitetet Zenel Hyka, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohen 5 (pesë) abonentë me kontratë furnizimi. Bashkëlidhur informacioni si vijon:

- Numri i konsumatorit ***, Kodra e Priftit, Tiranë.
- Numri i konsumatorit ***, Kodra e Priftit, Tiranë.
- Numri i konsumatorit ***, Barbas, n/stacioni Farkë.
- Numri i vjetër i kontratës ***, adresa Bicaj, kategoria familjare, Qarku Elbasan, n/stacioni Gramsh.
- Numri i konsumatorit ***, Spitalë, Durrës.

Me generalitetet Zenel Tahir Hyka, Lindita Ali Hyka, Elda Zenel Hyka dhe Erisa Zenel Hyka, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, nuk rezulton abonent apo kontratë e furnizimit me energji elektrike.

✚ **Ujësjetës Kanalizime Tiranë**, me shkresën nr. *** prot, datë 24.05.2023, konfirmon se në emër të Zenel Hyka, rezulton kontrata nr. ***, me adresë Rruga "Sadik Petrela", në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të likuiduara deri në mars 2023. Bashkëlidhur pasqyra e pagesave për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022.

✚ **14 Shoqëritë Rajonale të Ujësjetës - Kanalizime**, me shkresat nr. *** prot, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

✚ **Vodafone Albania sha**, me shkresën nr. *** prot, datë 13.07.2023, ka përcjellë CD me dokumentacion, ku konfirmohen pagesat e kryera për vitin 2022, në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të, në shumën totale rreth 59.000 lekë. Bashkëlidhur informacioni lidhur me numrat aktivë, si dhe kopje të kontratave përkatëse.

- **Me inventarin datë 26.06.2023**, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave, lidhur me konfirmimin e FSHU, sqaron se ka kontrata për energjinë elektrike vetëm për shtëpinë dhe ish Baxhon. Nuk ka asnjë lidhje me kontratat e tjera të cituara.

Subjekti paraqiti:

- Kopje libreze nr. konsumatori ***, nr. kontrate ***, Kodra e Priftit.
- Kopje libreze nr. konsumatori ***, nr. kontrate ***, Barbas, nënstationi Farkë, ish Baxho.
- **Në proces verbalin e datës 18.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaron se lidhur me shpenzimet e deklaruara për vitin 2022 për internet, kontrata është bërë fillimisht me Abcom dhe aktualisht ka kaluar me Vodafone.

Subjekti paraqiti:

- Kontratë pajtimi me Abcom, vlera 1.599 lekë/muaj.
- Fatura të pagesave mujore, me vlerë 1.599 lekë.

Me inventarin e datës 26.07.2023, subjekti ka paraqitur:

- Mandate elektronike të rimbushjes së celularit nga Lindita Hyka.
- 🚩 **Konstatohet se:** FSHU konfirmon se me gjeneralitetet Zenel Hyka, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohen 5 (pesë) abonentë me kontratë furnizimi, për të cilat subjekti ka dhënë shpjegime duke deklaruar se ka vetëm 2 (dy) kontrata; për shtëpinë tek "Kodra e Priftit" dhe ish "Baxho".
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e FSHU, UKT dhe Vodafone.**
- ✓ **Shpenzimet për ujë + drita + telefoni + internet, gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të, rezultojnë në total rreth 268.000 lekë.**
- ❖ **Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.**

19. Udhëtime jashtë shtetit për 3 (tre) vitet e fundit. Shuma 2.889 euro.

Zenel Hyka:

- 09.02.2021 - 12.02.2021, Stamboll me shërbim me urdhër të DPP Shtetit. Shpenzime 0 lekë.

Lindita Hyka:

- 05.09.2021 - 12.09.2021, Vjenë, Austri, me shërbim për nevoja pune nga Ministria e Financave. Shpenzime 0 lekë.
- 02.04.2022 - 03.04.2022, vizitë e organizuar turistike nga Ministria e Financave. Shpenzime 60 euro.
- 28.10.2022 - 31.10.2022, vizitë tek motra dhe vëllezërit në Udine, Itali. Shpenzime vetëm bileta avioni 70 euro. (shpenzimet të tjera për ushqim, akomodim, janë përballuar nga vëllezërit, d.m.th. në shtëpi).

Erisa Hyka:

- 15.10.2022 - 16.10.22, udhëtim me punën në Strugë, Maqedoni e Veriut. Shpenzimet i ka mbuluar puna.

Familja:

- 07.03.2020, udhëtim familjarisht në Kosovë me makinë. Shpenzime 150 euro.
- 27.03.2022 - 30.3.2022, vizitë familjarisht në Romë, Itali. Shpenzime gjithsej 731 euro (avioni 121 euro + hotel 410 euro + shpenzime të tjera 200 euro).

Udhëtime vetëm me dy vajzat:

- 28.11.2022 - 04.12.2022, udhëtim privat me dy vajzat në Bruksel (intervistë pune) dhe në Berlin, Gjermani, tek një shoqe e vajzave. Shpenzime gjithsej 752 euro (avioni TIR-Bruksel 72 euro + Amsterdam-Berlin 90 euro + Berlin -Prishtine 78 euro + hotel 212 euro + shpenzime të tjera 300 euro).

Udhëtime bashkëshortja me dy vajzat:

- 17.02.2023 - 21.02.2023, udhëtim privat në Milano (i priste motra e bashkëshortes). Shpenzime gjithsej 1.126 euro (avioni 291 euro + hotel 635 euro + shpenzime të tjera 200 euro).

Bashkëlidhur deklaratës:

- Shkresë nr. ***, datë 01.03.2023 "Kthim përgjigje" nga DPPSH, Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, bashkëlidhur së cilës gjendet raporti i hyrje daljeve në territorin shqiptar për shtetasit Zenel Hyka, Lindita Hyka, Elda Hyka dhe Erisa Hyka.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Shpenzimet e deklaruara për udhëtime private, janë 2.889 euro.**
- ❖ **Për arsimin e fëmijëve, madhore apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së percaktuar në nenin 32, të Ligjit të Vlerësimit.**

20. Shkolla e vajzave, Elda dhe Erisa Hyka, në katër vjet. Shuma 1.470.000 lekë.

Studime në Shkollën e Mesme "Harry Fultz": 4 vjet * 175.000 lekë/vit * 2 = 1.400.000 lekë.

Studime në UPT, Elda Hyka, 2016-2017 = 2 * 35.000 = 70.000 lekë.

Studime në UPT, Elda Hyka, 2016-2019. Shuma 105.000 lekë.

Studime në Fakultetin Ekonomik, UT, Erisa Hyka, 2017 - 2020. Shuma 54.000 lekë.

Studime master në UPT, Elda Hyka, 2020 - 2021. Shuma 204.000 lekë.

Hetimi Administrativ

Me inventarin e datës 26.07.2023, subjekti ka paraqitur:

- Vërtetim nr. ***, datë 16.06.2023, për pagesat e Erisa Hyka, në shkollën "Harry Fultz", në shumën 725.000 lekë, periudha 2014 - 2018.
- Vërtetim nr. ***, datë 16.06.2023, për pagesat e Elda Hyka, në shkollën "Harry Fultz", periudha 2012 - 2016, shuma 705.000 lekë.
- Vërtetim i Fakultetit të Ekonomisë, datë 14.10.2023, për pagesën e Erisa Hyka për vitin 2019 - 2020, në shumën 17.500 lekë. Për vitin 2020 - 2021 dhe 2021 - 2022, nuk ka bërë pagesë.

- Vërtetim nr. ***, datë 19.06.2023, nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, për pagesat e Elda Hyka, viti 2019 - 2022, në vlerën 279.400 lekë.
- ✓ **Rezultojnë shpenzime shkollimi të dokumentuara, për periudhën 2012 - 2022, në shumën totale rreth 1.727.000 lekë.**

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES - LINDITA HYKA

DEKLARIMI I PASURIVE

21. Llogari bankare e pagës në BKT, me nr. ***, Vlera 278.030 lekë, datë 08.03.2023. Pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: Kursime nga paga.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje e llogarisë së pagës datë 01.03.2023, nga BKT, ku figurojnë kreditimet e pagave për muajin dhjetor 2022 dhe gjëndja më datë 30.12.2022, në vlerën 117.839 lekë.

Hetimi Administrativ

✚ **BKT**, me shkresën nr. ***prot, datë 09.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në vlerën 273.030 lekë, datë 08.03.2023. Bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohen kreditimet e pagave për periudhën korrik 2014 - mars 2023.

- ✓ **BKT konfirmon gjëndjen e llogarisë në vlerën 278.030 lekë, datë 08.03.2023.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

22. Të ardhura nga paga neto si specialiste në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, nga viti 1994 (kur jemi fejuar) deri në vitin 2018. Shuma 15.232.000 lekë.

23. Të ardhura nga paga neto si specialiste në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, nga viti 2008 - 2022. Shuma 4.673.778 lekë.

24. Të ardhura nga paga neto si punonjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, periudha 01.01.2023 - 08.03.2023. Shuma 159.704 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Pasqyra përmbledhëse e pagave për periudhën janar 2018 - dhjetor 2022, shuma neto 4.673.778 lekë.

Hetimi Administrativ

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD me nxjerrje llogarie në emër të Lindita Hyka, ku evidentohen kreditime nga pagat prej muajit tetor 2004. Për periudhën janar 2006 - prill 2014, ka përfituar të ardhura nga paga dhe shpërblime, në shumën totale rreth 7.352.000 lekë.
- ✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot, datë 09.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet se Lindita Hyka, për periudhën maj 2014 - mars 2023, ka përfituar të ardhura nga paga, në shumën rreth 8.523.000 lekë.
- ✚ **Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.05.2023, konfirmon në emër të Lindita Hyka, llogari në vlerën 0.45 euro, datë fillimi 31.12.2007 dhe datë mbarimi 14.02.2011. Bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohen kreditim në shumën 1.525 euro (transfertë e brendshme), datë 14.09.2007, tërhequr në po të njëjtën datë me përshkrimin rroga/dieta.

Nga verifikimi i llogarisë bankare në Intesa Sanpaolo Bank, nuk ka rezultuar asnjë specifikim se nga kush është bërë kreditimi i llogarisë në vlerën 1525 euro, por vetëm citohet “transfertë e brendshme”.

- Në kthim përgjigjen nr. ***, datë 20.10.2023, subjekti sqaron se, pagesa është për shërbim për nevoja pune, të bashkëshortes së tij jashtë Shqipërisë. Në pamundësi për të gjetur një urdhër të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për këtë shërbim, ka paraqitur dokumentacion nga banka, e cili vërteton se rimbursimi i shpenzimeve, është bërë nga EU CAFAO Albania.
- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, konfirmon (pagat bruto dhe neto), periudha kontributive janar 2012 - mars 2023, të Lindita Hyka nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
Me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, i drejtohet Drejtorisë së Arkivit Qëndror Lundër, për të përcjellë informacionin e kërkuar për periudhën para vitit 2012.
- ✚ **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qëndror**, me shkresën nr. *** prot, datë 17.05.2023, informon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listpagesave për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguar në subjektet shtetërore juridike apo fizike, nuk mund të konfirmohen periudha kontributive apo paga mbi të cilën këta subjekte janë siguar, në qoftë se nuk jepet dokumentacioni përkatës nga ana e subjektit kërkues, lidhur me emërtimin e qendrës së punës, Nipt-in e subjektit, fotokopje e librezës së punës, etj. Bashkëlidhur vërtetim nr. *** prot, datë 12.05.2023, për vjetërsinë në punë, për efekt pensioni të Lindita Hyka, Nd/ja Bujqësore Kamëz, datë 11.03.1985.

Me inventarin e datës 05.07.2023, subjekti ka paraqitur:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 04.07.2023, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas të cilit Lindita Hyka (Zita), ka përfituar përveç të ardhurave nga pagat, edhe të ardhura nga skema e shpërblimeve, konform legjislacionit në fuqi, për vitin 1994, shuma 47.155 lekë;

vitin 1995, shuma 80.775 lekë; vitin 1996, shuma 51.605 lekë; vitin 1997, shuma 57.100 lekë; vitin 1998, shuma 191.720 lekë; vitin 1999, shuma 195.112 lekë; vitin 2000, shuma 267.302 lekë; vitin 2001, shuma 204.302 lekë; vitin 2002, shuma 452.442 lekë; vitin 2003, shuma 435.916 lekë; vitin 2004, shuma 365.402 lekë dhe vitin 2005, shuma 417.462 lekë. Në total për periudhën 1994 - 2005, shuma e të ardhurave nga skema e shpërblimeve rreth 2.766.000 lekë.

- Vërtetim nr. *** prot., datë 30.06.2023, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas të cilit Lindita Hyka (Zita), ka përfituar të ardhura nga pagat neto për vitin 1994, shuma 47.669 lekë; vitin 1995, shuma 115.320 lekë; vitin 1996, shuma 114.247 lekë; vitin 1997, shuma 106.803 lekë; vitin 1998, shuma 172.544 lekë; vitin 1999, shuma 155.039 lekë; vitin 2000, shuma 246.789 lekë; vitin 2001, shuma 258.503 lekë; vitin 2002, shuma 299.753 lekë; vitin 2003, shuma 389.942 lekë; vitin 2004, shuma 394.327 lekë dhe vitin 2005, shuma 402.406 lekë. Në total, për periudhën 1994 - 2005, shuma e të ardhurave nga pagat, rreth 2.703.000 lekë.

- ✓ **Të ardhurat e bashkëshortes nga pagat dhe shpërblime për periudhën 1994 - mars 2023, rezultojnë rreth 21.344.000 lekë, konfirmuar sipas dokumentacionit të paraqitur, si dhe konfirmuar nga sistemi bankar.**

DEKLARIMI I VAJZËS - ERISA HYKA

DEKLARIMI I PASURIVE

25. Llogari bankare e pagës në Raiffeisen Bank, me nr. ***. Vlera 35.753 lekë, datë 08.03.2023. Pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: Personi fizik me NIPT M120020087A.

Hetimi Administrativ

Me inventarin e datave 26.06.2023 dhe 05.07.2023, subjekti ka paraqitur:

- Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregtar, Erisa Hyka, Person Fizik.
 - Të dhënat e llogarisë bankare të Erisa Hyka në Raiffeisen Bank.
 - Nxjerrje llogarie Erisa Hyka PF, për periudhën 31.12.2022 - 26.06.2023, ku gjendja në datën 08.03.2023, është në shumën 35.753 lekë.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Llogaria i përket aktivitetit privat si person fizik.**

26. Llogari bankare rrjedhëse në BKT, me nr. ***. Vlera 6.287 lekë, datë 08.03.2023. Pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat.

Hetimi Administrativ

✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot, datë 09.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse nr. ***, në vlerën 6.287 lekë, datë 08.03.2023. Bashkëlidhur nxjerrje llogarie ku evidentohen kreditimet e pagave, për periudhën shtator 2022 – shkurt 2023.

✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e ardhur nga BKT.**

DEKLARIMI I TE ARDHURAVE

27. Të ardhura nga paga, si punonjëse në kompaninë Kreatix, periudha 01.04.2021 – qershor 2022. Shuma 745.770 lekë.
28. Të ardhura nga paga, si punonjëse në kompaninë Communication Progres, periudha korrik - gusht 2022. Shuma 48.000 lekë.
29. Të ardhura nga paga, si punonjëse në kompaninë Info Business Solution, periudha gusht 2022 - dhjetor 2022. Shuma 417.000 lekë.
30. Të ardhura nga paga, nga aktiviteti si person fizik me NIPT M12002008A, periudha 2021 - 31.12.2022. Shuma 10.400 euro.
31. Të ardhura nga paga, nga aktiviteti si person fizik me NIPT M12002008A, periudha 01.01.2023 - 09.03.2023. Shuma 650 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetime page, datë 03.03.2023, nga e-albania, periudha prill - dhjetor 2021, shuma totale neto, rreth 380.000 lekë.
- Vërtetime page, datë 03.03.2023, nga e-albania, periudha janar - dhjetor 2022, shuma totale neto, rreth 831.000 lekë.
- Vërtetim page, datë 03.03.2023, nga e-albania, periudha janar 2023, paga neto 98.205 lekë.
- Pasqyra përmbledhëse e pagave, për periudhën prill 2021 - dhjetor 2022, shuma neto 1.210.815 lekë.
- Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave, nga aktiviteti privat, për periudhën janar - shkurt 2023, shuma totale 11.700 euro (printuar nga sistemi). Vlera faturimit 650 euro.

Hetimi Administrativ

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet se Erisa Hyka, për periudhën mars - korrik 2019, ka përfituar të ardhura nga bursa në shumën totale rreth 56.000 lekë.

✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot, datë 09.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet se Erisa Hyka, për periudhën 09.09.2022 - 10.02.2023, ka përfituar të ardhura nga paga, në shumën 515.872 lekë.

✚ **Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet se Erisa Hyka, për periudhën 30.09.2019 - 01.09.2022, ka përfituar të ardhura nga paga, në shumën rreth 270.000 lekë. Gjendja e llogarisë më datë 08.03.2023, është në vlerën 15.517 lekë.

- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 30.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet se Erisa Hyka, për periudhën 30.04.2021 - 07.06.2022, ka përfituar të ardhura nga paga, në shumën 1.066.462 lekë. Gjendja e llogarisë më datë 08.03.2023, është në vlerën negative 1.081 lekë.
- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, konfirmon (pagat bruto dhe neto), periudha kontributive gusht 2019 - mars 2023, të Erisa Hyka nga Kreatx, Doal textil, IBS, Communication Progress dhe Erisa Hyka, me Nipt M120020084.
- ✚ **QKB**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se Erisa Hyka e datëlindjes 02.06.1999, me numër personal ***, figuron të jetë e regjistruar si person fizik, nga data 02.08.2021, me emrin "Erisa Hyka", pajisur me NUIS (NIPT) M12002008A. Statusi i subjektit është aktiv. Bashkëlidhur ekstrakti historik, sipas të cilit data e themelimit, 02.08.2021, fusha e veprimtarisë "kryerja e shërbimeve doganore në portalin e-albania, konsulencë për përgatitjen për çdo shërbim doganor, etj."
- ✚ **DPT**, me shkresën nr. *** prot, datë 12.05.2023, konfirmon se Erisa Hyka, me NIPT M12002008A, është tatim pagues në DRT Tiranë si person fizik, nga data 02.08.2021.
- ✚ **DRT Tiranë**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.05.2023, konfirmon se, sipas të dhënave në sistemin tatimor c@ts, rezulton Erisa Hyka e regjistruar si person fizik, me NIPT M12002008A, më datë 02.08.2021, me aktivitet shërbime doganore. Të ardhurat e deklaruara sipas të dhënave të deklaratave të dorëzuara në sistemin c@ts, janë si vijon:

| Viti | Qarkullimi | Fitimi | Fitimi pas tatimit |
|--------|------------|-----------|--------------------|
| 2021 | 316.505 | 268.805 | 268.805 |
| 2022 | 930.657 | 806.877 | 806.877 |
| Totali | 1.247.162 | 1.075.682 | 1.075.682 |

Është person fizik dhe nuk shpërndan dividend, pasi bazuar në nenin 5.6, "Vendim për destinimin e fitimit", të UMF nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, subjekti nuk ka detyrim të depozitohet pranë administratës tatimore, vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë, lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, pasi është person fizik. Ky subjekt nuk ka detyrime të papaguara.

- Në **proces verbalin e datës 18.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaron se vajza, Erisa Hyka, është njëkohësisht edhe e punësuar në Infsoft System, edhe me aktivitet privat si person fizik.

Me inventarin e datave 26.06.2023 dhe 05.07.2023, subjekti ka paraqitur:

- Nxjerrje llogarie Erisa Hyka PF, për periudhën janar 2023 - mars 2023, ku figurojnë kreditime për konsulencë doganore, në shumën totale 219.245 lekë.

- Urdhër pagesa për kontributet e sigurimeve shoqërore, periudha janar - mars 2023.
- Deklarata listëpagesa e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, periudha janar - mars 2023.
- ✓ **Të ardhurat nga pagat e vajzës Erisa Hyka, për periudhën shtator 2019 – shkurt 2023, konfirmohen nga sistemi bankar në shumën totale rreth 1.852.000 lekë.**
- ✓ **Të ardhurat nga aktiviteti privat për periudhën gusht 2021 - mars 2023, konfirmuar nga organet tatimore (periudha gusht 2021 - dhjetor 2022) dhe dokumentuar (janar - mars 2023), rezultojnë rreth 1.295.000 lekë.**
- ✓ **Për periudhën mars - korrik 2019, janë përfituar të ardhura nga bursa, rreth 56.000 lekë.**

DEKLARIMI I VAJZËS - ELDA HYKA

DEKLARIMI I PASURIVE

32. Llogari bankare e pagës në BKT me nr. ***. Vlera 82.200 lekë, datë 06.03.2023. Pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat.

Hetimi Administrativ

- ✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot, datë 09.05.2023, nuk e konfirmon llogarinë me nr. ***. Konfirmohet llogari rrjedhëse në lekë me nr. ***, me gjëndje me datë 08.03.2023, në vlerën 49.752 lekë.
- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 30.05.2023, konfirmon në emër të Elda Hyka, llogari page nr. ***, në vlerën negative prej 27.710 lekë.
- **Me inventarin datë 26.06.2023**, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave llogaria në BKT, është llogaria aktuale e pagës, si punonjëse në Soft Solucion me NIPT L11328009F, ndërsa llogaria në Credins Bank, është llogaria e pagës kur ishte punonjëse në R&T me NIPT J62001011Q, e cila ka patur të hapur një overdraft. Aktualisht është mbyllur si llogari.

Subjekti paraqiti:

- Marrëveshje Huaje në llogari rrjedhëse (overdraft), datë 12.03.2021, marrë nga Elda Hyka në shumën 79.000 lekë.

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se:

Llogaria bankare e pages, e deklaruar në BKT me nr. ***, është llogaria e pagës në Credins Bank. Llogaria e deklaruar është llogaria aktuale e pagës si punonjëse në Soft Solucion.

- ✓ **Llogaria rrjedhëse e pagës në BKT, konfirmohet në vlerën 49.752 lekë, ndërsa llogaria nr. ***, konfirmohet nga Credins Bank, në vlerën negative/debitore prej 27.710 lekë.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

33. Të ardhura nga paga, si punonjëse në kompaninë R&T, periudha 2019 - shkurt 2022. Shuma 697.404 lekë.
34. Të ardhura nga paga, si punonjëse në kompaninë Soft Solution shpk, periudha qershor 2022 - 31.12.2022. Shuma 416.870 lekë.
35. Të ardhura nga paga, si punonjëse në kompaninë Soft Solution shpk, periudha 01.01.2023 - 08.03.2023. Shuma 160.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetime page, datë 04.03.2023, nga e-albania, periudha nëntor 2019, shuma neto, 23.088 lekë.
- Vërtetime page, datë 04.03.2023, nga e-albania, periudha janar - dhjetor 2020, shuma totale neto, 324.724 lekë.
- Vërtetime page, datë 04.03.2023, nga e-albania, periudha janar - dhjetor 2021, shuma totale neto, 319.680 lekë.
- Vërtetime page, datë 04.03.2023, nga e-albania, periudha janar - dhjetor 2022, shuma totale neto, 470.151 lekë.
- Vërtetim page, datë 04.03.2023, nga e-albania, periudha janar 2023, paga neto 79.700 lekë.
- Pasqyra përmbledhëse e pagave për periudhën nëntor 2019 - dhjetor 2022.

Hetimi Administrativ

- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 30.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet se Elda Hyka, për periudhën 02.12.2019 - 13.04.2022, ka përfituar të ardhura nga paga, në shumën 695.424 lekë.
- ✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot, datë 09.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet se Elda Hyka, për periudhën korrik 2022 - mars 2023, ka përfituar të ardhura nga paga, në shumën rreth 633.000 lekë. Konfirmohet gjithashtu, llogari kursimi në vlerën 1.500 lekë, datë 08.03.2023, ku evidentohen transferta nga llogaria e pagës.
- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, konfirmon (pagat bruto dhe neto), periudha kontributive nëntor 2019 - mars 2023, të Elda Hyka, nga R&T dhe Soft & Solucion.

- ✓ **Të ardhurat nga pagat e vajzës Elda Hyka, për periudhën dhjetor 2019 - mars 2023, konfirmohen nga sistemi bankar, në shumën totale rreth 1.328.000 lekë.**

HETIMI ADMINISTRATIV

- ✚ **Banka e Shqipërise, Banka Tirana, Banka e Bashkuar e Shqipërise, Banka e Parë e Investimeve, ABI Bank, Banka OTP Albania, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landesleasing, RFZ Invest, Credins Invest, Easypay, Fondi Besa, Institucioni Financiar Noa, Iutecredit Albania, Kredo Finance, One Albania, Albania Satellite Communications, Abissnet, Digicom,** konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur nuk janë kliente të tyre, çka përputhet me deklarimin.
- ✚ **ASHK, Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së,** dhe konkretisht: **Tiranë Veri, Tirana Rurale 2, Tropojë, Bulqizë, Pukë, Elbasan, Kolonjë, Has, Peqin, Durrës, Kukës, Skrapar, Kamëz Vorë, Mallakastër, Lushnje, Gramsh, Malësi e Madhe, Kucovë, Kavajë, Mat, Sarandë, Lezhë, Zonat e Stimuluara, Gjirokastër, Pogradec, Berat, Korçë, Fier, Krujë, Devoll, Librazhd, Mirditë, Tepelenë, Përmet, Kurbin, Shkodër, Dibër,** nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.
- ✚ **Raiffeisen Bank,** me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD të llogarisë në emër të Zenel Hyka, ku evidentohet kreditim në shumën 495.285 lekë, datë 01.07.2010, me përshkrimin: transferuar nga fondet me kërkesë të klientit, sporteli i bonove të thesarit". Tërhequr shuma 500.000 lekë, datë 05.10.2010.
- ✚ **BKT,** me shkresën nr. *** prot, datë 09.05.2023, konfirmon në emër të Lindita Hyka, llogari kartë krediti me limit 69.000 lekë dhe transfertë në vlerën 1.725 euro, datë 20.08.2021, nga AEI GMG.
- ✚ **Intesa Sanpaolo Bank,** me shkresën nr. *** prot, datë 11.05.2023, konfirmon në emër të Lindita Hyka, transaksion datë 07.12.2018, në shumën 2.492 USD.
- ✚ **Credins Bank,** me shkresën nr. *** prot, datë 30.05.2023, konfirmon në emër të Elda Hyka, llogari visa prepaid student në vlerën 304 lekë dhe Erisa Hyka, llogari visa prepaid student pa lëvizje.
- **Me inventarin datë 26.06.2023,** të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave,
 - Llogaria kartë krediti në emër të Lindita Hyka, në BKT, është kartë krediti prima që aktualisht e ka në përdorim, ndërsa transferta në shumën 1.725 euro, janë dieta nga shërbimi i punës në Austri, Projekt i BE.
 - Vlera 2.492 USD, në Intesa Sanpaolo Bank, janë dieta nga shërbimi i punës në Gjenevë.
 - Llogaritë visa prepaid student në emër të Erisa dhe Elda Hyka, në Credins Bank, janë llogari studenti.

- Në proces verbalin e datës 18.07.2023, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaron se shuma 500.000 lekë, tërhequr nga Raiffeisen Bank në vitin 2010, është mbajtur në shtëpi dhe përdorur gjatë kohës sipas nevojave familjare.
- Në kthim përgjigjen nr. ***, datë 26.10.2023, subjekti ka konfirmuar qëndrimin e mbajtur pranë ILDKPKI, mbi kreditimet e llogarive bankare të bashkëshortes së tij tek BKT dhe Intesa Sanpaolo Bank, duke bashkëlidhur Urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nr. *** prot., datë 01.07.2018 dhe nr. *** prot., datë 01.09.2021, mbi shërbimet e punës jashtë vendit.

✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me konfirmimet e mësipërme nga institucionet bankare.**

🚩 **Union Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 23.05.2023, konfirmon se:

- Lindita Hyka, ka patur llogari bankare të përbashkët me shtetasin G.Z, në vlerën 0 lekë.
- Elda Hyka, ka llogari në vlerën 38.268 lekë. Bashkëlidhur nxjerrje llogarie ku evidentohen pagesa të kësteve të kredisë, si dhe plani i amortizimit të kredisë, në shumën 128.000 lekë, datë 27.04.2021.

Më datë 08.03.2023, kredia ka patur detyrim të mbetur, në vlerën 6.344 lekë, detyrim i likuiduar në prill 2023.

- Me inventarin datë 26.06.2023, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave, shtetasi G.A, është vëllai i bashkëshortes dhe mund të kenë hapur llogari, por ajo nuk kujton të ketë pasur llogari bankare dhe as të kenë kryer veprime. Elda Hyka ka marrë kredi për blerje telefoni.

Subjekti paraqiti:

- Plan Pagesa e datës 27.04.2021, për kredi në shumën 128.000 lekë, datë fillimi 27.04.2021, datë mbarimi 20.4.2023.

✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me konfirmimet e Union Bank.**

🚩 **Ak Invest**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.05.2023, konfirmon se:

- Lindita Hyka, ka kryer një transfertë si dërguese, në shumën 50 euro, datë 18.05.2020, marrës A.Z.
- Elda Hyka, ka kryer një transfertë si përfituese në shumën 630 euro, datë 16.12.2021, dërgues I.B, Gjermani.

Bashkëlidhur CD me transaksionet e kryera, ku: Lindita Hyka ka marrë 50 euro nga R.Z, Itali, datë 19.05.2015; Elda Hyka ka marrë 100 euro, datë 20.02.2017 nga E.Z, Itali.

- Me inventarin datë 26.06.2023, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave, bashkëshortja ka dy vëllezër dhe motrën me banim në Itali. Këto janë transfertë për urime të ditëlindjeve. Elda Hyka ka marrë një transfertë nga shoqja e saj në Gjermani, I.B, për tek prindërit e saj që jetojnë në Shqipëri.

✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me konfirmimet nga AK Invest.**

✚ **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se Zenel Hyka dhe personat e lidhur, nuk kanë automjete në pronësi.

Me inventarin datë 26.06.2023 të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave, nuk ka mjet në përdorim, pasi e kanë shitur automjetin Mercedes Benz me targë ***, në vitin 2021.

Subjekti paraqiti:

- Kontratë shitblerje nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 01.12.2016, ku Lindita Hyka blen automjetin Mercedes Benz, në shumën 3.000 euro.
- Kontratë shitje nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 27.06.2021, ku Lindita Hyka shet automjetin Mercedes Benz, me targë ***, në vlerën 200.000 lekë.

✓ **Konfirmohet Automjeti Mercedes Benz, nga shpjegimet dhe dokumentacioni i paraqitur.**

✚ **QKB**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se Elda Hyka, figuron të jetë e regjistruar si aksioner deri më datë 10.01.2012, në shoqërinë me emrin "Qumështi Ajka", pajisur me NUIS (NIPT) J61904048S. Statusi i subjektit është pezulluar. Bashkëlidhur ekstrakti historik.

- **Me inventarin datë 26.06.2023**, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, sipas të cilave, nuk ka asnjë lidhje me këtë konstatim. Nga kërkimi i bërë, rezulton se me Vendimin nr. ***, datë 03.08.2000, të K. K. Pronave, ish pronarëve të Bashkisë Tiranë dhe disa akteve të trashëgimisë, përfituese është Elda Rexhep Hyka dhe jo Elda Zenel Hyka.

Subjekti paraqiti:

- Raport për shpërndarjen e aksioneve të pronarëve të truallit, "Qumështi Ajka", Tiranë, ku figuron Elda R. Hyka trashëgimtare sipas vendimit nr. ***, datë 03.08.2000, të K. K. Pronave, ish pronarëve të Bashkisë Tiranë dhe Akteve të trashëgimisë me nr. ***, datë 11.10.1993, etj.

✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me konfirmimin e QKB.**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të Zenel Hyka dhe personave të lidhur.

✚ **APP**, me shkresën nr. *** prot, datë 17.07.2023, konfirmon se Erisa Hyka, deklaruar si person fizik, me NIPT (NUIS) M12002008A, rezulton se është regjistruar në SPE, datë 02.08.2021, por nuk rezulton fitues në ndonjë procedurë prokurimi elektronik.

- ❖ Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se;
- Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 08.03.2023, është deklaruar bruto 17.206.615 lekë dhe neto rreth 10.877.000 lekë.
- Të ardhurat e subjektit nga pagat, shpërblime etj., për periudhën shtator 1990 - mars 2023, rreth 24.077.000 lekë.
- Të ardhurat e bashkëshortes nga pagat dhe shpërblime, për periudhën 1994 - mars 2023, rreth 21.344.000 lekë.
- Të ardhurat e vajzës Erisa Hyka nga pagat, për periudhën shtator 2019 - shkurt 2023, rreth 1.852.000 lekë. Për periudhën mars - korrik 2019, janë përfituar të ardhura nga bursa, rreth 56.000 lekë.
- Të ardhurat e vajzës Elda Hyka nga pagat për periudhën dhjetor 2019 - mars 2023, rreth 1.328.000 lekë.

Gjithashtu, janë deklaruar dhe përdorur si burim:

- Të ardhura neto nga shitja e apartamentit përfituar nga EKB, në shumën 2.140.000 lekë (blerë 860.000 leke, shitur 3.000.000 lekë).
- Të ardhura neto nga heqja dorë e të drejtave pasurore, mbi tokën me sip. 1000 m², Radhimë, në shumën 400.000 lekë (blerë 100.000 lekë, shitur 500.000 lekë).
- Të ardhura neto nga aktiviteti i fermerit, për periudhën 2012 - 2019, rreth 1.505.000 lekë. (Qarkullimi total rreth 19.862.000 lekë.)
- Të ardhura neto nga aktiviteti privat i vajzës, Erisa Hyka PF, për periudhën gusht 2021 - mars 2023, rreth 1.295.000 lekë.
- Huamarrje motrës në vitin 2017 (për shlyerje të kredisë së fermerit), në shumën 2.500.000 lekë (e pashlyer).
- Kredi bankare në Procredit Bank (për financimin e fermerit), shuma fillestare 20.000.000 lekë. Detyrimi i mbetur 3.829.870 lekë.
- Kredi bankare në Raiffeisen Bank, në shumën totale 1.500.000 lekë. Shlyer.
- Për periudhën 2000 - mars 2023, referuar treguesve statistikore të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar, rreth 15.740.000 lekë.
- Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon dhe internet, në total rreth 263.000 lekë.


- Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, janë deklaruar shpenzime për udhëtime private, personale apo të personave të lidhur, në total 2.889 euro, e konvertuar rreth 331.000 lekë (kursi i këmbimit valutor nga Banka e Shqipërisë, datë 08.03.2023, ku 1 euro = 114.4 lekë).
- Për periudhën deri në datën 08.03.2023, janë shpenzuar për shkollimin e fëmijëve, në total rreth 1.727.000 lekë.
- Për periudhën shtator 2021 - mars 2023, janë shpenzuar për pagesat e kësteve të kredisë, në Procredit Bank, rreth 1.288.000 lekë.
- Për mobilimin e shtëpisë së banimit, janë shpenzuar ndër vite rreth 943.000 lekë, ndërsa në vitin 2017 janë shpenzuar për pagesën e parcelës ndërtimore, rreth 173.000 lekë.


Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- ✓ **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- ✓ **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- ✓ **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- ✓ **Nuk është kryer deklaram i rremë;**
- ✓ **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit**

B. KONTROLI I FIGURËS

 Objekti i kontrollit të figurës, është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;

3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërma (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

✚ Trupa e Vlerësimit, ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Z. Zenel Hyka, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës” të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit Z. Zenel Hyka, në zbatim të nenit 36, pika 1, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
- b. Raportin e hollësishëm mbi kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit nr. *** prot., datë 18.07.2023, të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ **Drejtorja e Analizës dhe Sigurisë së Personelit**, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar raportin e hollësishëm mbi kontrollin e figurës, të subjektit të vlerësimit, nr. *** prot., datë 18.07.2023, ku ka konstatuar se:

a) **Subjekti i vlerësimit z. Zenel Tahir Hyka, me detyrë Drejtor i Departamentit për Shërbimet Mbështetëse, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Nuk ka pasur emër dhe mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur me ndonjë nofkë, emër dhe mbiemër tjetër nga ai që ka të regjistruar.
- Nuk ka pasur nënshtetësi tjetër.
- Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale.
- Ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale
- Ndaj tij nuk është lëshuar ndonjëherë një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk ka marrë ndonjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Nuk ka dijeni që ndonjë nga anëtarët e familjes së tij, është përfshirë/dyshohet për përfshirje në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.

- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës.
- Nuk ka dijeni që një nga anëtarët e familjes ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë/dyshuar për përfshirje krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një anëtar i familjes ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë/dyshuar për përfshirje krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s, gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk ka pasur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit, për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keqtrajtuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre të veçantë apo gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie apo nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar si dhe as tentuar apo kryer aktivitet të paautorizuar, në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka qënë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit.

Subjekti ka nënshkruar dy vetëdeklarime, për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre, të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

Hetimi Administrativ

- Trupa e Vlerësimit, në mbështetje të neneve 35 – 42, të ligjit 12/2018, i ndryshuar, si dhe në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse dhe raportit nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit, ka kryer hetimin mbi kontrollin e figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit, **nga ku konstatoi se:**
- 🚩 **Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile**, me shkresën nr. *** prot. datë 14.05.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Hyka, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjëndjes civile.
- 🚩 **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresën nr. *** prot., datë 19.05.2023, bën me dije se subjekti i vlerësimit Z. Hyka, nuk rezulton i dënuar.

- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Hyka, nuk disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare apo në veprimtari të kundraligjshme.

- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023 dhe me shkresën nr. *** prot. datë 30.05.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Hyka, nuk administrohen informacione ose materiale, mbi përfshirjen e tij në aktivitete të kundërligjshme.

- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot., datë 31.05.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Hyka, nuk figurojnë informacione të regjistruara për veprimtari kriminale.

- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën e datën 13.06.2023, shkresën nr. *** prot. datë 21.06.2023 dhe shkresën nr. *** prot. datë 26.05.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Hyka, nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitete të kundërligjshëm dhe nuk ka procedime penale të referuara.

- ✚ **Institucionet ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot. datë 27.06.2023 dhe shkresën nr. *** prot. datë 08.06.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Hyka, nuk është nxjerrë urdhër ndalimi, nuk është kërkuar masë e sigurimit personal (masa shtrënguese/masa parandaluese, sipas përcaktimeve të nenit 227 të Kodit të Procedurës Penale) dhe vlerësimi i tyre nga Gjykata, nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale sipas përcaktimi të nenit 278 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.

- ✚ **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, më shkresën nr. *** prot. datë 25.05.2023, se subjekti i vlerësimit Z. Hyka, është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), në nivelin "Tepër Sekret" lëshuar me datë 26.04.2022, e vlefshme deri më datë 25.04.2027. Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP. AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

- ✚ **Avokati i Popullit**, me shkresën nr. *** prot. datë 30.05.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Hyka, nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime, në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës, si dhe nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

- ✚ **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**, me shkresën nr. *** prot. datë 08.06.2023, se subjekti i vlerësimit Z. Hyka, nuk ka qënë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.

- ✚ **Në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore**, për subjektin e vlerësimit Z. Hyka, nuk disponohen denoncime nga publiku dhe nuk disponohen ankesa për të.

✚ Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, me qëllim vlerësimit e besueshmërisë, ka kryer në datën 19.10.2023, testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara nga Ekzaminimi Toksikologjiko – Ligjor, për përdorim lëndësh narkotike, nr. *** prot., datë 03.11.2023, konkludohet se subjekti vlerësimit **Z. Zenel Tahir Hyka**,

- **Akualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.**

✚ Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikqyrjes Policore, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Zenel Tahir Hyka:

- ✓ **Ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;**
- ✓ **Nuk ka informacion në deklaramin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.**

C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

✚ Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale, është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit, në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.

- ✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetet në dy elemente:
 - të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
 - raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar.

✚ Subjekti i vlerësimit Z. Zenel Hyka, më datë 10.03.2023, ka dorëzuar pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Formularin e

Vlerësimin të Aftësive Profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1, të Ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

- ✚ Në dispozitën e Nenit 44, pika “2” dhe “3” të Ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, është përcaktuar se: “Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet” dhe “Në rast se punonjësi, në momentin e plotësimit të formularit të vlerësimit profesional, ka më pak se 5 vjet në gradën dhe/ose pozicionin që mban , periudhë vlerësimi konsiderohet e gjithë koha e ushtrimit të detyrës në institucionin përkatës”.
- ✚ Subjekti i vlerësimit **Z. Zenel Hyka**, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- ✚ Struktura e burimeve njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin 46, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar raportin e vlerësimit profesional, të subjektit të vlerësimit, nr. *** prot., datë 30.06.2023, ku në konkluzionin përfundimtar, shprehet se:
 - a) **“Punonjësi i policisë z. Zenel Tahir Hyka është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban”.**

Hetimi Administrativ

- Trupa e Vlerësimit, në mbështetje të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe bazuar në të dhënat e administruara në dosjen e subjektit të vlerësimit, të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, ka kryer hetimin e plotë mbi aftësitë profesionale të subjektit të vlerësimit, **nga ku është konstatuar si më poshtë:**

1. Niveli i arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, të subjektit të vlerësimit:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale, është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punës, sipas parashikimit të nenit 45, pika 2, gërma a e Ligjit 12/2018, të ndryshuar.

- ❖ Në Formularin e Aftësive Profesionale të plotësuar nga subjekti, ka rezultuar se ka kryer studimet si më poshtë:
 - 1997 – 1981 – Studime të arsimit të mesëm, Shkolla e Mesme Ekonomike – Lezhë.
 - 1982 – 1985 – Studimet e Larta në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve – Tiranë, Dega Pravijë.
 - 1988 – 1990 – Studime pas universitare Akademia e Shtabit të Përgjithshme (2 vjet me shkëputje nga puna)
- ✚ Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të Subjektit ka rezultuar:
 - Vërtetim nr. *** prot., datë 25.03.1982, i arsimit të mesëm, në Shkollën e Mesme Ekonomike – Lezhë, dega Ekonomist Kontabël.
 - Kopje e Diplomës së Shkollës së Lartë “Dega Prapavijë”, në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, me vendim të komisionit shtetëror nr. ***, datë 25.07.1985, nr i regjistrimit ***.
 - Kopje e Diplomës së Kursit 2 vjeçar “Dega Prapavijë”, në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, me vendim të komisionit shtetëror nr. ***, datë 12.06.1990, nr i regjistrimit ***.
- ✓ **Në kuptim të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, rezulton se subjekti i vlerësimit, për periudhën e përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, sipas ecurisë së tij në karrierë, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor për funksionet që ka ushtruar në vite dhe në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.**

2. Të dhënat për punësimin dhe ecuria në karrierë:

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, përcaktohet se: “Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 (pesë) vjet”.

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale, është ecuria në karrierë dhe fitimi i gradave, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma dh, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

✚ Subjekti i vlerësimit Z. Zenel Hyka, ka një karrierë në Policisë e Shtetit prej 38 vitesh. Në formularin e aftësive profesionale, plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit, rezulton se 5 (pesë) vitet e fundit, subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

- Nga data 01.04.2016 deri më 31.08.2021, ka kryer detyrën e Shefit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Mbështjetjes Logjistike, në Departamentin për Shërbimet Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

- Nga data 01.09.2021 deri më 13.06.2022, ka kryer detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Mbështetjes Logjistike, në Departamentin për Shërbimet Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - Nga 16.02.2022 deri më 13.06.2022, ka qënë i komanduar në detyrën e Drejtorit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - Nga data 14.06.2022 dhe aktualisht, ka kryer detyrën e Drejtorit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- ✚ Nga aktet e dosjes së personelit, rezulton se subjekti i vlerësimit deri në momentin e deklarimit ka përfituar gradat policore si më poshtë:
- **Grada Drejtues**, sipas urdhrorit nr. *** prot., datë 11.06.2008, “Për dhënien e gradës policore të një punonjësi policie”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
 - **Status i Nëpunësit Civil** sipas urdhrorit nr. *** prot., datë 03.02.2014, “Për lirimin nga strukturat policore dhe emërimin në strukturat e shërbimeve mbështetëse të një punonjësi policie”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
 - **Grada Drejtues** sipas urdhrorit nr. *** prot., datë 29.03.2016, “Për rikthimin në strukturat policore dhe emërimin në detyrë të z. Zenel Tahir Hyka”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
 - **Grada Drejtues i Parë** sipas urdhrorit nr. *** prot., datë 05.05.2022, “Për dhënien e gradës policore të një punonjësi policie”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
 - **Grada Drejtues i Lartë** sipas urdhrorit nr. *** prot., datë 08.06.2022, “Për emërimin në detyrë dhe dhënien e gradës policore Drejtues i Lartë, të një punonjësi policie”, nga Ministri i Brendshëm.
- ✓ **Pas kontrollit dhe verifikimit me dokumentacionin e sipërpërmendur, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit Zenel Hyka, arrijmë në konkluzionin se, funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.**

3. Vlerësimet e punës:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë vlerësimet e punës, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma ç, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

- ✚ Në dosjen personale të subjektit të vlerësimit, për periudhën 2018 – 2022, janë administruar 5 (pesë) vlerësime të aftësive individuale të punës. Nga administrimi i këtyre akteve, rezulton se gjatë 5(pesë) viteve të fundit, subjekti i vlerësimit është vlerësuar nga punëdhënësit për rezultate individuale të punës, me vlerësimin “**Shumë Mirë**”.

Vlerësimet përkatëse si vijon:

- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018 28 Pikë (shumë mirë)

- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019 28 Pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 28 Pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 28 Pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 100 Pikë (shumë mirë)

✚ Avokati i Popullit, me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, nuk konfirmon të ketë pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative, të nisura kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Zenel Hyka.

✚ Pranë AMP-së, nuk kanë ardhur denoncime apo ankesa nga publiku për subjektin, për sjellje joprofesionale dhe joetike, gjatë ushtrimit të detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

✓ **Bazuar në vlerësimet e sipërmendura, të administruara në dosjen personale të subjektit, arrihet në konkluzionin se, subjekti ka përmbushur detyrat profesionale dhe funksionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë n kryerjen e detyrave funksionale.**

4. Respektimi i rregullave të etikës:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë masat disiplinore, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma d, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

✚ Nga verifikimi në dosjen personale dhe sistemin RMIS, rezultoi se gjatë periudhës 5 (pesë) vjeçare, (2018 - 2023), subjekti i vlerësimit Z. Zenel Hyka, nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Gjithashtu, nga verifikimi i dosjes personale, bazuar në vlerësimet e aftësive individuale të punës nga eprorët ndër vite, në lidhje me respektimin e rregullave të etikës, ka rezultuar se: subjekti shfaq integritet dhe standarde të larta etike, është shëmbull i mirë për organizatën.

✓ **Nga verifikimet e kryera, arrihet në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë.**

5. Kualifikimet dhe trajnimet:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë certifikatat e trajnimeve dhe medaljet, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma c, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

✚ Nga verifikimi i dosjes personale, si dhe pikës 3, të pjesës 3, të formularit të aftësive profesionale, të dorëzuar nga subjekti, rezulton se gjatë periudhës 5 (pesë) vjeçare, është pajisur me çertifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit, si më poshtë:

➤ Trajnim në vitin 2008, Komunikimi, Delegimi i pushteteve, Menaxhimi i Ndryshimit;

- Trajnim në vitin 2007, Procesi i menaxhimit të biznesit;
- Trajnim në vitin 2007, Menaxhimi i cilësisë;
- Trajnim në vitin 2007, Menaxhimi i projekteve;
- Trajnim në vitin 2017 “Seminar on non-traditional security threats for Albania” në Republikën Popullore të Kinës;
- Trajnim në vitin 2022 “Për fitimin e gradës Drejtues i Parë”;
- Trajnim mbi formimin për instruktor;
- Trajnime periodike për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA)
- Trajnim për Menaxhimin e Burimeve Materiale dhe Financiare në Oslo, Norvegji, organizuar dhe realizuar nga Misioni i BE-së MAPE
- Trajnim për formim instruktori dhe prezantim në Akademinë e Sigurisë.

Megjithëse trajnimet e kryera nga subjekti, nuk janë në periudhën sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ato gjithsesi janë të lidhura me thellimin e njohurive, shtimin e vlerave dhe rritjen e performancës në ushtrimin e profesionit të profilit të tij.

Konstatohet se:

Trajnimet dhe pajisja me çertifikata trajnimi, është kryer gjatë ushtrimit të detyrës së tij si punonjës i strukturës dhe se ato janë të lidhura dhe në përputhje me objektin e ushtrimit të funksioneve të tij në detyra të ndryshme ku ka punuar.

- ✓ **Nga verifikimet e kryera arrihet në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë.**

6. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, ëorkshope, botime.

🚩 Subjekti i vlerësimit Z. Zenel Hyka, në Formularin e Aftësive Profesionale, ka deklaruar se për periudhën objekt vlerësimi, është angazhuar si vijon:

- Në analiza të menaxhimit të shërbimeve mbështetëse në polici.
- Në prezantimin e menaxhimit të buxhetit, menaxhimin e shërbimeve material.
- Në menaxhimin e ndryshimit dhe të menaxhimit të cilësisë.
- Për disa vite ka prezantuar menaxhimin e proceseve dhe të metodave të analizës së tyre.
- Ka qënë lektor në prezantimin e Menaxhimit të projekteve, zhvillimin e organizatës, menaxhimin e buxhetit, ligjshmëria dhe procesi i prokurimit publik në A, D kryesisht në trajnimet për Gradat Drejtues.
- Ka kryer prezantime dhe analiza të drejtimit me anë të të dhënave statistikore krahasuese.
- Është pjesëmarrës në shumë Grupe Pune të akteve administrative dhe normative në Organizatën e Policisë Shtetit.
- Është bashkëpunëtorë i vazhduar në të gjitha prezencat e partnereve të BE-së dhe SHBA-së në Polici, ku ka marrë vlerësime në vite.
- Ka qënë pjesë kryesore e të gjithë studimeve për ndryshimet në organizatën e Policisë.

🚩 **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit si dhe verifikimin mbi përmbushjen e detyrave funksionale, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Zenel Tahir Hyka:

- ✓ *Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trainimin përkatës për funksionin;*
- ✓ *Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;*
- ✓ *Ka vlerësime pozitive pune.*

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha provat dhe shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, në përfundim të procesit të vlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Zenel Tahir Hyka, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku tre kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **Zenel Tahir Hyka**, me funksion Drejtor i Departamentit për Shërbimet Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 02.02.2024, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Kryesues

Denisa SINA

Relator
Suela BULKU

Anëtar
Arben SEFAJ